

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.1/2, Janar - Shkurt 2015

Koha e Kreshmëve është një periudhë e shenjët dhe e vlerësueshme në vitin kishtar. Kjo kohë përfshin 40 ditët që u paraprijnë Pashkëve. Zë fill të Mërkurën e Përhime e mbyllet me Meshën e mesnatës në ditën e së Shtunës së Madhe. Ndahet në dy periudha: pesë të dielat, që në liturgji njihen me emrin „të Dielat e Kreshmëve“ dhe java e fundit, “Koha e Mundimeve”, në të cilën vendin kryesor e zë Java e Madhe. Kreshmët janë kohë përgatitjeje që na përcjellin shpirtërisht drejt mistereve të mëdha të Pashkëve. Na përgatisin që të marrim pjesë e t' i gëzojmë frytet e mundimeve, vdekjes e të ngjalljes së Krishtit. Me Krishtin e ngjallur, ngadhënjyes mbi mëkatën e mbi mbretërinë e errësirës, edhe ne, do të ngjallemi për një jetë të re, me plotë hir e dashuri, më plot virtyte e vepra të mira. Ky është qëllimi kryesor i këtyre ditëve të shenjta të kreshmëve. Tri janë veçoritë, që e dallojnë këtë kohë: **pendesa, pastërtia e lutja.**

Pendesa është tema kryesore e Liturgjisë së Kreshmëve.

Kreshmet - pendës 40 ditore, në Besëlidhjen e Vjetër kanë të bëjnë me shtegtimin 40-vjetësh të Izraelit nëpër shkretëtirë (krhs. Dal, 16,35); takimin 40-ditor të Moisiut me Hyjin në Sinaj (krhs. Dal, 24,18) dhe agjërimin 40-ditor të Elisë deri në malin Horeb (krhs. 1 Mb, 19,8).

Pendesë bëri që Krishti i cili agjëroi 40 ditë në shkretëtirë para se të fillonte jetën e vet publike. (krhs. Mt 4,40), Pendësë bënë edhe Apostujt dhe Shenjtërit. Natyrisht, pendimi është shprehje e arsyeshme për fyerjet që i kemi bërë Zotit. Është shenjë përvujtërimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit. Ky lloj qortimi ka vijuar nga koha e antikitetit deri në ditët tona.

Shpirtit i pendesës ka lënë gjurmë të pashlyeshme në Liturgjinë e Kreshmëve.

Kjo gjë shprehjet në kremtime, agjërim dhe paraqitjen e lutjeve; në ndryshimin e ngjyrave në veshjet liturgjike, sjelljet fetare me karakter pendestarë etj..

Është e vërtetë se sot, Kisha katolike, duke u përshtatur nevojave të kohës, në përgjithësi për besimtarët, sikur i ka thjeshtësuar pendesat trupore; por kjo nuk do të thotë se i krishteri duhet të heqë dorë nga pendesa e Kreshmëve. Mos të harrojmë se pendesa duhet thjeshtësuar, por nuk duhet harruar, sepse ajo, është e vetmja rrugë e shëlbimit që na çliron prej mëkatit duke na sjellur shëlbimin.

Kreshmët, koha që na përgatit për festën e Pashkëve



Papa Françesku JO INDIFERENCËS SË PËRBOTSHME!	4
Redaksia SKLLAVËRIA MODERNE	7
Redaksia BASHKIMI I KISHËS	8
Imzot George Frendo JO MË SKLLEVËR, POR VËLLEZËR	9
Don Pren Kola FJALOR LITURGJIK KISHTAR	13
Don Nosh Gjolaj MIRËNJOHJA E TË DREJTËS	16
Radio Vatikani BARIU SHPIRTEROR	20
Don Lush Gjergji I FRYMËZUAR NGA FEJA DHE DASHURIA	21
Ndue Dedaj TË MËDHENJTË E SHEKULLIT XX	23
Dom Nikë Ukgjini VËZHGIME PËR LETËRSINË BIBLIKE - XANONI	25
Redaksia SHËN VALENTINI MARTIR	29
Redaksia MENDJE TË NDRITURA	31
VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 1/2 (472-473) Janar - Shkurt 2015

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
nike.ukgjini@gmail.com
Web page: kishakatolikeshkoder.com
Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

JO INDIFERENCËS SË PËRBOTSHME!

Mesazhi i Papës Françesku për Kreshme 2015

Të dashur vëllezër e motra,

Kreshmët janë një kohë ripërtëritje për Kishën, për bashkësitë e për çdo besimtar. Por mbi të gjitha ama është një “kohë hiri” (2 Kor 6,2). Hyji nuk na kërkon asgjë të cilën nuk na e ka dhënë më parë: “Ne duam, sepse ai na ka dashur i pari” (1 Gjn 4,19). Ai nuk është indiferent ndaj nesh. Secilin prej nesh e ka për zemër, na njih emër për emër, kujdeset për ne e na kërkon kur ne largohemi prej tij. Secili prej nesh i intereson; dashuria e tij e pengon atë të jetë indiferent ndaj asaj çka na ndodh neve.


Por ndodh që kur ne jemi mirë dhe ndjehemi rehat, sigurisht që harrojmë të tjerët (një gjë që Hyji Atë nuk e bën kurrë), nuk na interesojnë problemet e tyre, vuajtjet dhe padrejtësitë që pësojnë ... atëherë zemra jonë bie në indiferencë: ndërkohë që unë jam pak a shumë mirë dhe rehat,

harroj ata që nuk janë mirë. Kjo sjellje egoiste, indiferente, sot ka marrë një përmasë botërore, në atë pikë sa që mund të flasim për një indiferencë të përbotshme. Kemi të bëjmë me një problem me të cilin ne si të krishterë duhet të përballemi. Kur populli i Hyjit kthehet në dashurinë e tij, gjen edhe përgjigjet për ato pyetje që vazhdimisht historia i vendos përballë.

Një nga sfidat më urgjente mbi të cilën dua të ndalem në këtë mesazh është ajo e globalizimit të indiferencës. Indiferenca ndaj të afërmit dhe ndaj Hyjit është një tundim real për ne të krishterët. Kemi nevojë për këtë arsye që për çdo kreshme të dëgjojmë klithjen e profetëve të cilët ngrenë zërin e na zgjojnë. Hyji nuk është indiferent ndaj botës, por e do aq shumë sa që ka dhënë të Birin për shëlbimin e çdo njeriu. Në mëshirimin, në jetën tokësore, në vdekjen dhe ngjalljen e Birit të Hyjit, hapet përfundimisht dera ndërmjet Hyjit dhe njeriut, ndërmjet qiellit dhe tokës.

Dhe Kisha është si një dorë që e mban të hapur derën nëpërmjet shpalljes së Fjalës, kremtimitin e sakramenteve, dëshminë e fesë që bëhet e frytshme në dashuri (krh. Gal 5,6). Megjithatë bota priret të mbyllet në vetvete dhe të mbyllë atë derë nëpërmjet të cilës Hyji hyn në botë dhe bota në Të. Kështu dora, që është Kisha, nuk duhet kurrë të befasohet nëse i japin shtysmën, nëse shtypet apo plagoset.

Populli i Hyjit për këtë arsye ka nevojë të përtërihet, që të mos bëhet indiferent e të mos mbyllet në vetvete. Do të doja t'ju propozoja tre vargje për të medituar për këtë përtëritje.



1. “Nëse një gjymtyrë vuan, të gjitha gjymtyrët vuajnë” (1 Kor 12,26) – Kisha.

Dashuria e Hyjit që thyen këtë mbyllje vdekjeprurëse në vetvete dhe që e ka emrin indiferencë, na jepet prej Kishës me anë të mësimin të saj e sidomos me anë të dëshmisë së saj. Por mund të dëshmohet vetëm diçka që më parë kemi sprovuar. I krishteri është ai i cili e lejon Hyjin ta veshë me mirësinë dhe mëshirën e tij, ta veshë

me Krishtin, që të bëhet si Ai, shërbëtor i Hyjit dhe i njerëzve. Na e kujton mjaft mirë këtë gjë Liturgjia e të Enjtes së Madhe me anë të ritit të larjes së këmbëve. Pjetri nuk donte që Jezusi t'i lante këmbët, por më pas e kuptoi se Jezusi nuk dëshiron vetëm të jetë një shembull se si duhet t'ia lajmë këmbët njëri-tjetrit. Këtë shërbim mund ta bëjë vetëm kush më parë ka lejuar Krishtin t'ia lajë këmbët. Vetëm ky ka “pjesë” me të (Gjn 13,8) e rrjedhimisht mund t'i shërbejë njeriut. Kreshmet janë një kohë e volitshme që ta lejojmë Krishtin të na shërbejë e kështu të bëhemi si ai.

Kjo ndodh kur dëgjojmë Fjalën e Hyjit dhe kur marrim sakramentet, veçanërisht Eukaristinë. Në të bëhemi çka marrim: Trupi i Krishtit. Në këtë trup ajo indiferencë që duket shpesh se merr pushtet mbi zemrat tona, nuk gjen vend. Pasi kush është i Krishtit i përket një trupi të vetëm dhe në Të ne nuk jemi indiferentë ndaj njëri-tjetrit. “Pra nëse një gjymtyrë vuan, të gjitha gjymtyrët vuajnë bashkë me të; e nëse një gjymtyrë nderohet, të gjitha gjymtyrët nderohen me të” (1 Kor 12,26). Kisha është bashkësi shenjtërisht, pasi marrim pjesë shenjtërit, por edhe sepse është një bashkësi gjërash të shenjta: dashuria e Hyjit që na është zbuluar në Krishtin e të gjitha dhurata e tij. Ndër ta është edhe përgjigja e atyre tek të cilët mbërrin një dashuri e tillë.

Në këtë bashkësi shenjtërisht dhe në këtë pjesëmarrje në gjërat e shenjta askush nuk zotëron



vetëm për veten e tij, por ajo çka ka është për të gjithë. E pasi jemi të lidhur në Hyjin, mund të bëjmë diçka edhe për ata që janë larg, për ata që me anë të vetëm fuqive tona nuk mundemi kurrë t'i mbërrijmë, sepse me ta e për ta lusim Hyjin që të gjithë t'i hapemi veprës së tij të shëlbimit.

2. “Ku është vëllai yt?” (Zan 4,9). – Famullitë dhe bashkësitë.

Sa thamë për kishën Universale është e nevojshme ta përkthejmë në jetën e famullive dhe të bashkësive. A ia dalim në realitete të tilla kishtarë të përjetojmë pjesëmarrjen në një trup të vetë? Një trup që së bashku merr dhe ndan me të tjerët aq sa Hyu ka dashur të japë? Një trup që i njeh dhe kujdeset për gjymtyrët e veta më të dobëta, më të varfëra e më të vogëla? Apo strehohemi në një dashuri të përgjithshme që angazhohet larg në botë, por harron Lazrin e ulur përpara derës së mbyllur? (krh. Lk 16,19-31).

Për të marrë e për të bërë të frutshme plotësisht atë çka marrim prej Hyjit duhet të tejkalohen kufijtë e Kishës së dukshme në dy drejtime. Në vend të parë, duke u bashkuar me Kishën e qiellit në lutje. Kur Kisha tokësore lutet, krijohet një bashkim i ndërsjellët shërbimi dhe mirësie që mbërrin deri para fytyrës së Hyjit. Së bashku me shenjtërit që kanë gjetur plotësinë e tyre në Hyjin,

formojmë një pjesë të asaj bashkësie në të cilën indiferenca mundet prej dashurisë. Kisha e qiellit nuk është riumfuese pse i ka kthyer shpinën vuajtjeve të botës dhe gëzon e vetme. Por shenjtërit mund të sodisin e t'i gëzohen faktit që me vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit kanë mundur përfundimisht indiferencën, ngurtësimin e zemrës dhe urrejtjen. Derisa kjo fitore e dashurisë të mos depërtojë gjithë botën, shenjtërit ecin së bashku me ne si shtegtarë. Shën Tereza e Lizjës, doktore e Kishës, shkruante e bindur se gëzimi në qiell për fitoren e dashurisë së kryqëzuar nuk do të jetë i plotë derisa edhe një njeri i vetëm mbi tokë do të vuajë e do të gjëmojë: “Kam shpresë shumë se nuk do të jem pasive në qiell, dëshira ime është të punoj ende për Kishën e për shpirtërat” (Letra 254 e 15 korrikut 1879).

Edhe ne marrim pjesë në meritat dhe gëzimet e shenjtërve edhe ata marrin pjesë në luftën dhe dëshirën tonë për paqe dhe pajtim. Gëzimi i tyre për fitoren e Krishtit të ngjallur është për ne një motiv force për të tejkaluar shumë prej formave të indiferencës dhe të ngurtësisë së zemrës. Nga ana tjetër çdo bashkësi e krishterë është thirrur të kalojë pragun që e vendos në marrëdhënie me shoqërinë që e rrethon, me të varfërit e të largët. Kisha për vetë natyrën e saj është misionare, jo e palosur mbi veten e saj, por është e dërguar tek të gjithë njerëzit. Ky mision është dëshmia plotë e Atij që dëshiron të çojë te Ati të gjithë realitetin dhe çdo njeri. Misioni është ajo çka dashuria nuk mund ta heshtë. Kisha i shkon pas Jezusit në rrugën që e çon drejt çdo njeriu, deri në skajet e tokës (krh. Vap 1,8). Kështu pra mund të shohim tek i afërm ynë vëllanë dhe motrën për të cilët Krishti ka vdekur dhe është ringjallur. Atë çka kemi marrë e kemi marrë edhe për ata. E po ashtu, ajo çka këta vëllezër zotërojnë është një dhuratë për Kishën e për krejt njerëzimin. Të dashur vëllezër e motra, sa do të doja që vendet ku shfaqet Kisha, famullitë tona dhe bashkësitë tona në mënyrë të veçantë, të bëhen ishuj dashurie në mes të detit të indiferencës!

3. “Forconi zemrat tua” (Jak 5,8) – Besimtari.

Edhe si besimtarë të veçantë kemi tundimin e indiferencës. Jemi të tejmbushur me lajme e shëmbëllime tronditëse që na rrëfejnë vuajtjen njerëzore dhe ndjejmë në të njëjtën kohë gjithë paaftësinë tonë për të bërë diçka. Ç'të bëjmë

atëherë për të mos u përthithur prej kësaj vorbulle frike dhe pafuqie? Në radhë të parë mund të lutemi në bashkim me Kishën tokësore dhe qiellore. Të mos lëmë mënjanë forcën e lutjes të shumë njerëzve bashkë. Nisma 24 orë për Hyjin që uroj të kremtohet në të gjithë Kishën, edhe në nivel dioqezan në datat 13 dhe 14 mars, dëshiron të shprehë këtë nevojën tonë për t'u lutur.

Në radhë të dytë, të mund të ndihmojmë me vepra dashurie, duke mbërritur goftë ata që janë afër e goftë ata që janë larg, falë edhe shumë organizmave të bamirësisë të Kishës. Kreshmja është një kohë e volitshme për të dëftuar këtë interes ndaj tjetrit me anë të ndonjë shenje, edhe të vogël, por konkrete, të pjesëmarrjes tonë në njerëzinë e përbashkët. E në vend të tretë, vuajtja e tjetrit përbën një thirrje për kthim, sepse nevoja e vëllait më sjell ndërmend brishtësinë e jetës time, vartësinë time nga Hyji dhe nga vëllezërit. Nëse përvujtërisht kërkojmë hirin e Hyjit dhe pranojmë kufijtë e mundësive tona, atëherë do të kemi besim në mundësitë e pafund që ruan për ne dashuria e Hyjit. E atëherë mund t'i bëjmë ballë tundimit djallëzor që na bën të besojmë se mund të shëlbohemi e mund ta shpëtojmë botën të vetëm. Për të tejkaluar indiferencën dhe mëtimin tonë të gjithëpushtetësisë, do t'ju kërkoja të gjithëve të jetojmë këtë kohë kreshmeje si një rrugëtim formimi të zemrës, sikurse pat thënë edhe Benedikti XVI (Letra encicklike, *Deus caritas est*, 31). Të kesh një zemër plot dhembshuri nuk do të thotë të kesh një zemër të dobët. Kush dëshiron të jetë i dhembshëm ka nevojë për një zemër të fortë, të ngultë, të mbyllur për tunduesin, por të hapur për Hyjin. Një zemër që e lejon Shpirtin të depërtojë brenda saj dhe ta mbartë në rrugët e dashurisë që çojnë drejt vëllezërve dhe motrave.

Në fund të fundit një zemër e varfër që pranon të metat e saj dhe jepet për tjetrin. Prandaj të dashur vëllezër e motra dëshiroj t'i lutem Krishtit me ju në këtë Kreshmë: “Fac cor nostrum secundum cor tuum” “Bëj që zemra ime t'i përngajë zemrës sate” (Lutja e Litanisë së Zemrës së Krishtit). Atëherë do të kemi një zemër të fortë dhe të dhembshme, të zgjuar dhe bujare, që nuk lejon të mbyllet në vetvete dhe nuk bie në marramendjen e një indiference të përbotshme. Me këtë urim, ju siguroj lutjen time në mënyrë që çdo besimtar dhe çdo bashkësi kishtare të përshkojë frytshëm rrugëtimin kreshmor dhe ju kërkoj të luteni për mua. Zoti ju bekoftë e Zoja e bekuar ju mbrojte.

PAPA FRANÇESKU ME KRERË TË TJERË FETARË: “skllavëria moderne, krim kundër njerëzimit” !

(Vatikan, 2 dhjetor 2014)

Në Ditën ndërkombëtare për zhdukjen e skllavërisë, që u mbajt në Vatikan me 2 dhjetor 2014 Papa Françesku dhe krerë të feve të tjera, për herë të parë në histori, nënshkruan një deklaratë të përbashkët, ku pohohet se format e ndryshme të skllavërisë moderne, si trafikimi i njerëzve, puna e detyruar dhe prostitucioni, trafikimi i organeve e çdo lloj praktike kundër koncepteve themelore të barazisë, lirisë e dinjitetit të njeriut, duhet të konsiderohen krime kundër njerëzimit e të njihen si të tilla nga çdo qenie njerëzore e nga çdo komb. Në meditim të tij, Papa Françesku qe tejet i ashpër e përdori fjalën “humaniteti i cenuar”:

“Shfrytëzimi fizik, ekonomik, seksual e psikologjik i burrave dhe i grave, i djemve dhe i vajzave të vogla, aktualisht, i lidh dhjetëra miliona njerëz në zinxhirin e ç njerëzisë e të poshtërit. Çdo njeri – burrë, grua, djalë, vajzë – është imazh i Zotit... prandaj çdo njeri është i lirë... Pavarësisht nga përpjekjet e mëdha të shumë vetëve, skllavëria moderne vazhdon të jetë një plagë e tmerrshme, e pranishme në shkallë të gjerë në të gjithë botën, madje, edhe në fushën e turizmit. ... U bëjmë thirrje të gjithë njerëzve të fesë, liderëve, qeverive, ndërmarrjeve, të gjithë burrave e grave vullnetmirë, që ta mbështesin fuqimisht e të shtojnë radhët e lëvizjes kundër skllavërisë moderne në të gjitha format e saj”.

Një impenjim i përbashkët, që i kërkohet çdo besimi fetar të botës e çdo njeriu vullnetmirë, për të ndërmarrë veprime konkrete e nisma feje, të cilat synojnë zhdukjen e skllavërisë moderne. Autoritetet më të larta kishtarë katolike, anglikane, ortodokse, së bashku me liderët e feve budiste, hinduiste, hebraike dhe myslimane, u mbledhën në Vatikan nga Global Freedom Network (Rrjeti Global i Lirisë), organizatë ndërfetare, që është themeluar në Vatikan më 17 mars 2014 e që ka të njëjtin qëllim me deklaratën e sotme. Vërtet, liderët fetarë u zotuan të punojnë që skllaveritë moderne të zhduken brenda vitit 2020. Në takim, u ndoqën edhe video mesazhet e Patriarkut Ekumenik Bartolomeu I dhe të Ajetollahut të Madh, shehut Bashir Husein al Naxhafi, të cilët nuk mundën të merrnin pjesë personalisht. Ja deklarata:

“Ne, të nënshkruarit, jemi mbledhur sot këtu për një nismë historike, me qëllim frymëzimin e

veprimtarive shpirtërore e praktike, nga ana e të gjitha feve të botës e nga ana e të gjithë njerëzve vullnetmirë, për të zhdukur përgjithmonë skllavërinë moderne brenda vitit 2020.

Në sytë e Zotit (Imami i madh i Al Azharit përdor këtu fjalën 'fetë'), çdo njeri, vajzë a djalë, grua a burrë, është i lirë, i destinuar të jetojë për të mirën e të gjithëve, në barazi e në vëllazëri. Format e ndryshme të skllavërisë moderne, si trafikimi i njerëzve, puna e detyruar dhe prostitucioni, trafikimi i organeve e çdo lloj praktike kundër koncepteve themelore të barazisë, lirisë e dinjitetit të njeriut, duhet të konsiderohen krime kundër njerëzimit.

Këtu e sot, angazhohemi bashkarisht për të bërë ç'është e mundur, brenda bashkësive tona të besimtarëve e jashtë tyre, që t'i rijapim lirinë kujt është viktimë e skllavërisë, ose i trafikut të njerëzve, duke i rikthyer shpresën në të ardhmen. Sot kemi mundësinë, vetëdijen, urtinë, mjetet më të reja dhe teknologjitë e nevojshme për të arritur këtë objektiv human dhe moral”.

Këta nënshkruesit:

Për Kishën Katolike: Papa Françesku.

Për fenë hinduiste: Shenjtëria e Tij Mata Amritanandamayi (Amma)

Për fenë budiste: Mjeshtri Zen Thich Nhat Hanh (Thay) (i përfaqësuar nga i Përndrituri Bhikkhuni Thich Nu Chan Khong)

Po për fenë budiste: I Përndrituri Datuk K Sri Dhammaratana, Kryemeshatar i Malezisë.

Për fenë hebraike: Rabini Abraham Skorka.

Po për fenë hebraike: Kryerabini David Rosen KSG, CBE.

Për Kishën Ortodokse: Shenjtëria e Tij, Patriarku Ekumenik Bartolomeu I (i përfaqësuar nga Fortlumenturia e Tij, Emmanuel, Mitropolit i Francës).

Për fenë myslimane: Mohamed Ahmed El-Tayeb, Imam i Madh i Al Azharit (përfaqësuar nga Dr. Abbas Abdalla Abbas Soliman, Nënsekretar i Shtetit të Al Azhar Alsharif).

Po për fenë myslimane: Ajetollahi i Madh Mohammad Taqial-Modarresi.

Po për fenë myslimane: Ajetollahi i Madh, shehu Basheer Hussain al Najafi (përfaqësuar nga shehu Naziyah Razzaq Jaafar, Këshilltar i veçantë i Ajetollahut të Madh).

Po për fenë myslimane: Shehu Omar Abboud.

Për Kishën Anglikane: Hirësia e Tij, Justin Eëlby, Kryepeshkëv i Kanterburit.

PAPA: TË PUNOJMË TË GJITHË PËR BASHKIMIN E KISHËS, KËSHTU BËHEMI MË TË FORTË

Çdo i krishterë është i thirrur të punojë për bashkimin e Kishës. Në meshën e mëngjesit, Papa Françesku nënvizoi se duhet ta lemë veten në dorën e Shpirtit Shenjt, i cili e realizon bashkimin në Kishë, duke ruajtur ndryshueshmërinë mes njerëzve.

Është përsëri Letra e Shën Palit drejtuar Efesianëve, një nga leximet liturgjike të sotme, në qendër të reflektimit të Atit të Shenjtë. Nga burgu, Apostulli i Popujve kërkon të bëhet ç'është e mundur për të qëndruar të bashkuar. Gjatë gjithë historisë, vuri në dukje Papa, kjo është puna e Kishës dhe e çdo të krishteri: të sigurojë unitetin. Pastaj Ati i Shenjtë dha shembullin e shën Pjetrit Apostull, i cili flet për Kishën si për një tempull me gurë të gjallë, në ndryshim nga tempulli i mendjemadhësisë si Kulla e Babelit. I pari, nënvizoi Papa, sjell bashkim, ndërsa tjetri është simbol i përçarjes dhe i moskuptimit: *"Realizimi i bashkimit në Kishë, ndërtimi i Kishës, i këtij tempulli, i këtij uniteti në Kishë: kjo është detyra e çdo të krishteri, e secilit prej nesh. Kur duhet të ndërtojmë një tempull apo një pallat, kërkojmë një zonë të përshtatshme dhe e përgatisim. Gjëja e parë që bëjmë është të kërkojmë gurin bazë, gurin e këndit, thotë Bibla. E guri i këndit i Kishës është Jezusi, ndërsa guri i këndit i bashkimit të Kishës është lutja e Jezusit në Darkën e Mbrame: 'Atë, qofshin një!'. E kjo është forca!"*.

Jezusi, vazhdoi Papa Françesku, është guri mbi të cilin ndërtojmë bashkimin në Kishë. Por, kush e ndërton këtë unitet? E Papa nënvizoi se kjo është detyra e Shpirtit Shenjt, i vetmi, që mund të krijojë unitet në Kishë, duke bashkuar në një popuj, kultura e njerëz të ndryshëm, pa ua prekur identitetin. Shën Pjetri thotë se ne jemi gurë të gjallë në këtë ndërtesë, ndërsa Shën Pali na këshillon të jemi të brishtë. Por ç'do të thotë kjo?

"Përvujtëri, ëmbëlsi, shpirtmadhësi: janë brishtësi, sepse i përvuajturi duket sikur nuk duhet për

gjë; ëmbëlsia, butësia, duket sikur nuk shërbejnë; shpirtmadhësia, hapja e zemrës për të gjithë, të kesh një zemër të madhe... E pastaj, shkon edhe më larg: 'Durojeni njëri-tjetrin me dashuri'. Ta durojmë njëri-tjetrin me dashuri, duke pasur për zemër, çfarë? Ruajtjen e bashkimit. E ne bëhemi aq gurë më të fortë në këtë tempull, sa më të brishtë dukemi me virtytet e përvujtërisë, të shpirtmadhësisë, të ëmbëlsisë, të butësisë".

Kjo është udha e përshkuar nga Jezusi, i cili u tregua i brishtë deri në Kryq, e u bë i fortë, theksoi Papa. Kryelartësia, mendjemadhësia, nuk nevojiten. Kur fillohet një ndërtesë është e nevojshme që arkitekti të bëjë projektin. E cili është projekti i bashkimit në Kishë, pyeti sërish Ati i Shenjtë:

"Shpresa, për të cilën jemi të thirrur të gjithë: shpresa se shkojmë drejt Zotit, shpresa se jetojmë në një Kishë të gjallë, ndërtuar me gurë të gjallë, me forcën e Shpirtit Shenjt. Vetëm me projektin e shpresës mund të ecim përpara drejt bashkimit në Kishë. Jemi të thirrur për një shpresë të madhe. Të shkojmë aty! Por me forcën që na jep lutja e Jezusit për bashkimin; me urtinë e Shpirtit Shenjt, i cili është i aftë të na kthejë nga tulla në gurë të gjallë; e me shpresën se do të gjejmë Zotin që na ka thirrur, do ta gjejmë kur të plotësohen kohërat".



Imzot George Frendo
Tiranë

JO MË SKLLEVËR, POR VËLLEZËR

Mund të themi se argumenti i mesazhit të Papës për këtë vit, me rastin e Ditës së Paqes më 1 janar, është si shtojcë e mesazhit të vjetshëm. Tema për Ditën e Paqes vjet ishte “Vëllazëria, Themel dhe Rugë për Paqen”. Sivjet, tema është “Jo më Skllavër, por Vëllezër”. Domethënë ajo vëllazëri që është themeli dhe rruga për paqen përjashton çdo formë skllavërie.

Në fillim të mesazhit, të frymëzuar ndoshta nga filozofia e Martin Buber-it, Papa Françesk pohon se “njeriu është një qenie në marrëdhënie, i destinuar të realizohet në kontekstin e marrë-dhënieve ndër personale të frymëzuara nga drejtësia e dashuria”. Këto fjalë të fundit janë shumë të rëndësishme, sepse cilësojnë marrëdhëniet ndër personale.

Jo çdo marrëdhënie mes dy personash meriton të quhet “marrëdhënie ndër personale”, por vetëm ajo marrëdhënie që vlerëson tjetrin si “person”, si njeri, që nuk është thjesht një kafshë e zhvilluar, por një qenie e veçantë, që, sipas tregimit të krijimit në librin e Zanafillës, është krijuar në përngjasimin e Hyjit. Prandaj Papa Françesk specifikon se këto marrëdhënie duhet të jenë “të frymëzuara nga drejtësia e dashuria”. Për këtë arsye, Papa vazhdon duke thënë se zhvillimi i njeriut kërkon që “të njihen e respektohen dinjiteti, liria dhe autonomia e tij”. Kështu, zhvillimit të marrëdhënieve me të vërtetë ndër personale i kundërvihet “plaga gjithmonë e përhapur e shfrytëzimit të njeriut nga ana e njeriut” (n. 1).

Titulli i Mesazhit

Titulli i këtij mesazhi është frymëzuar nga fjalët e Shën Palit në letrën e tij drejtuar Filemonit. Filemoni kishte një skllav me emër Onezim, i cili u arratis nga pronari i tij. Onezimi u takua me Shën Pali dhe u pagëzua nga ai. Atëherë Pali i shkruan bashkëpunëtorit të vet Filemonit duke e nxitur ta pranojë Onezimin “jo më si skllav, por shumë më tepër se skllav, porsì vëlla i dashur” (Flm 16). Por



para se të flasë shprehimisht për skllavërinë dhe për format e ndryshme të skllavërisë, Papa Françesk tërheq vëmendjen mbi kontrastin e madh mes situatës origjinale të njeriut, të krijuar mashkull dhe femër, me të njëjtën natyrë dhe dinjitet dhe të bekuar prej Zotit, dhe situatës së mëvonshme, kur mëkati ndërpreu vëllazërinë dhe “vazhdimisht deformon bukurinë dhe fisnikërinë e të qenurit vëllezër e motra të së njëjtës familje njerëzore”. Këtu Papa përmend shembullin e Kainit, i cili prej smirës vrau vëllanë e vet Abelin. Përmend gjithashtu historinë e familjes së Noehut dhe të bijve të tij, kur dashakeqësia e Kamit, një nga djemtë e Noehut, e nxiti Noehun ta mallkojë djalin mosrespektues (2).

Dhe mund të shtoj se njeriu vazhdon të përrjetojë pasojat e mëkatis origjinal, siç janë: egoizmi, krenaria, xhelozia. Këto janë pengesë për ndërtimin e paqes, dhe njeriu, shoqëria, shtetet duhet t'i luftojnë në qoftë se duan të angazhohen seriozisht për të ndërtuar paqen. Papa Françesk, në mëkatin, që është largimi prej Hyjit dhe prej vëllezërve, sheh shprehjen “e mospranimi të bashkimit” e cila “përkthehet në kulturën e nënshtrimit”. Dhe këtu përmend “rrjedhojat që kjo sjell dhe që zgjasin nga breznia në brezni: mospranimi i tjetrit, keqtrajtimi i personave, shkelja e dinjitetit dhe e të drejtave themelore, institucionalizimi i pabarazive”.

Këto që ka përmendur Papa Françesk janë mëkate që kanë ekzistuar në çdo periudhë të historisë njerëzore. Ajo që na çudit është fakti që,

pas shumë vitesh pas shpalljes së të drejtave të njeriut, në dhjetor 1948, të drejtat më themelore të njeriut janë të shkelura haptazi në shumë vende të botës. Ajo që na çudit është fakti se, ndërsa krenohemi për pluralizmin që, veçanërisht pas rënies së komunizmit, është përhapur në shumicën e vendeve të botës, dhe ndërsa pluralizmi parimisht duhet të krijojë një atmosferë më tolerante, në fakt ka hapur dyert për forma të reja intolerance raciale dhe fetare dhe anti-semitizmi, si kemi parë edhe në vende Ballkanike, shumë afër nesh. Në vitin 1989 Francis Fukuyama botoi esenë *The End of History?* në të cilin shprehu mendimin e tij se pas rënies së ideologjive bota do të përjetojë një periudhë paqësore. Por sigurisht Fukuyama u zhgënjye duke parë se faktet e kundërshtonin “profecinë” e tij. Në 1995 Fukuyama botoi librin me titull *Trust*, që si nën-titull kishte *The Social Virtues and the Creation of Prosperity*. Në këtë libër ai ka qenë shumë më pesimist (ose më mirë të themi se ishte realist), dhe ka theksuar nevojën për ato social virtues që e bënë të mundshme të jetojmë në një shoqëri më të denjë për njeriun: virtues that make communities livable.

Fytyrat e Ndryshme të Skllavërisë

Në fund të n. 2, para se të flasë për “fytyrat e ndryshme të skllavërisë dje dhe sot” Papa ka cituar fjalët e Jezusit në darkën e tij të fundit: “Nuk ju thërras më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk di çka bën zotëria i tij; unë ju quajta miq, sepse ju zbulova gjithçka që dëgjova prej Atit tim”.

Pastaj, në n. 3, vijon pjesa më interesante e mesazhit, ku Papa Françesk flet për format e ndryshme të skllavërisë. Së pari Papa flet për institucionin e skllavërisë, një institucion shumë i lashtë, dhe që ishte pranuar dhe miratuar në shumë kultura, i rregulluar nga ligji. Ky ligj “caktonte se kush lindte i lirë dhe kush, në të kundërt, lindte skllav, si dhe se në çfarë kushtesh personi, i lindur i lirë, mund ta humbte lirinë e vet, apo ta rifitonte atë”. Natyrisht, një institucion i tillë kundërshtoi jo vetëm Shkrimin e Shenjtë, që tregon një dinjitet shumë të veçantë për njeriun, por edhe ligjit natyror, që tregon natyrën e veçantë të njeriut, i cili nuk mund të çmohet si një objekt pronësie. Dhe çuditërisht institucioni i skllavërisë ka vazhduar të ekzistojë edhe në kohë moderne. Madje zbulimi i kontinentit amerikan e forcoi dhe është përpjekur të justifikojë këtë institucion. Mjaft të përmend këtu fjalët e një shkrimtari spanjoll të shekullit 16, Sepulveda, i cili, në një latinishte shumë elegante

dhe në stilin e Dialogëve të Platonit, shkroi: “Duhet të pranojmë se njerëz të urtë dhe të aftë kanë autoritet të drejtë dhe natyror të sundojnë mbi njerëz më të ulët se vetja. Spanjollët kanë çdo të drejtë të sundojnë mbi barbarët e botës së re, sepse këta barbarë, për sa i përket urtisë, mençurisë, fuqisë dhe njerëzores janë aq inferiorë ndaj spanjollëve, sa fëmijët janë inferiorë ndaj të rriturve, gratë ndaj burrave, të paqytetëruarit ndaj të qytetëruarve, majmunët ndaj njerëzve”.

Papa Françesk vëren se “sot, pas një evolucioni pozitiv të ndërgjegjes së njerëzimit, skllavëria, krim i njerëzimit të cënuar, është shfuqizuar formalisht në botë”. Megjithatë Papa vazhdon të ankohet se, mjerisht, edhe sot, “miliona persona – fëmijë, burra e gra të çdo moshe – privohen prej lirisë dhe detyrohen të jetojnë në kushte të ngjashme me ato të skllavërisë”.

Cilat janë këto forma të reja skllavërie? Papa përmend, në vendin e parë, punëtorët, në vende ku “legjislacioni i punës nuk është në përputhje me normat e me standardet minimale ndërkombëtare”, domethënë në ato vende ku nuk janë njohur të drejtat e punëtorëve, e prandaj punëtori nuk është i mbrojtur, dhe më lehtësisht mund të shfrytëzohet. Por edhe në vendet ku legjislacioni e mbron punëtorin, ekzistojnë shumë raste ku të drejtat e tij janë shkelur. Para pak kohe kam pasur rast të shkruaj për gjendjen e mjerë të shumë punëtorëve. Kam shkruar se edhe pse ekzistojnë ligje shumë të drejta për t'i mbrojtur punëtorët, megjithatë në praktikë “s'ka kontroll mbi rrogën që marrin punëtorët... s'ka kontroll as mbi orët e punës... s'ka kontroll as për shkarkimin nga puna... Teorikisht po, flitet në ligjin për të drejtat e tyre dhe detyrat e punëdhënësve, por në fakt situata është shumë e ndryshme. Shume punëdhënës përfitojnë nga fakti se punëtorët janë të pambrojtur... përfitojnë nga numri i lartë i papunësisë... punëtori nuk do të protestojë, nga frika se do të shkarkohet, ose nga frika se nuk do të gjejë një punë tjetër. Sa shumë punëtorë të shkretë kënaqen me një rrogë shumë të ulët, vetëm sepse, thonë, 'më mirë kaq sesa hiq!'”

Pastaj Papa flet për kushtet e jetës së shumë migrantëve. Përmend itinerarin e tyre, shumë të rrezikshëm, gjatë të cilit “vuajnë prej urisë, privohen prej lirisë, zhvishen prej të mirave të tyre dhe keqpërdoren fizikisht dhe seksualisht”. Dhe çfarë gjejnë pas këtij udhëtimi aq të tmerrshëm? Shpeshherë mbahen “në kushte çnjerëzore”, “pranojnë të jetojnë e të punojnë në kushte të padenja”. Mund të shtoj edhe përluljet që shumë e

shumë herë duhet të përjetojnë, për shkak të paragjytimeve dhe urrejtjes që ekzistojnë në shumë vende kundër migrantëve, që konsiderohen si uzurpues e vendit të destinacionit.

Forma e tretë e skllavërisë për të cilën flet Papa Françesk është e personave që janë “të detyruar të prostituohen, mes të cilëve ka shumë të mitur”, “skllavet e skllëvërit seksualë”, “gratë e detyruara të martohen”, gratë “e shitura për martesë” ose “e përçuara në pasardhësi një familjari pas vdekjes së bashkëshortit” ndoshta pa pëlqimin e saj. Edhe pse raste të tilla mund të jenë të rralla në Shqipërinë e sotme, megjithatë ende ekzistojnë shumë raste, veçanërisht në shumë fshatra, kur me martesë vajza bëhet si skllave e familjes së bashkëshortit. Në vitin 2002 Diana Çuli ka shkruar: “Shoqëria shqiptare është e tronditur nga dhuna e egër e ushtruar mbi gratë, dhunë që nuk shfaqet vetëm në vajzat e trafikuar, por është e pranishme brenda familjes deri në ekstreme të frikshme, veçanërisht në zonat rurale”. Dhe Sevim Arbana ka shkruar: “Shumica e grave në Shqipëri ende s’kanë zërin e tyre. Ato drejtohen dhe manaxhohen, në mënyrën më patriarkale nga bota mashkullore (burri, babai, vëllai) dhe e kanë të vështirë për të shkuar përpara, për të luftuar apo për të ndryshuar situatën ku ato ndodhen. Shpesh ato janë pa shpresë, pa fuqi, pa zë”. Sigurisht, në këto 12 vitet e fundit situata e gruas ka përmirësuar, por mendoj se duhet të angazhohemi më shumë për emancipimin e saj.

Pastaj përmenden personat që janë bërë “objekt i trafikut dhe i tregtisë për eksplantimin e organeve, për t’u rekrutuar si ushtarë, për të lypur, për veprimtaritë e paligjshme sikurse prodhimi apo shitja e substancave narkotike, ose për forma të maskuara të birësimit ndërkombëtar”. Besoj se këto situata nuk ekzistojnë në Shqipëri, përveç rasteve kur përdoren fëmijët ose të rinjtë për të lypur apo për të shitur drogë.

Më në fund Papa përmend viktimat e terroristëve, që grabiten dhe mbahen në robëri si luftëtarë ose, në rast të vajzave dhe grave, si skllave seksuale. “Disa prej tyre zhduken, disa shiten disa herë, torturohen, gjymtohen, apo vriten”. Këtu nuk mund të mungoj të përmend ato më shumë se dyqind vajza nga Chibok në Nigeri të grabitur para



10 muajsh, si edhe mijëra të vvarë në atë vend nga Boko Haram. Pse asnjë vend nuk ka bërë asnjë protestë kundër terroristëve Boko Haram si është bërë kundër terroristëve në Paris? Pse asnjë President ose Kryeministër nuk ka derdhur lot për këto vajza ose për viktimat e tjera në Nigeri si kanë derdhur lot për Charlie Hebdo. Pse asnjë person nuk ka ngritur tabelë me fjalë “Unë jam vajza nga Chibok”, si kanë ngritur tabelë me fjalë “Unë jam Charlie”? Ndoshta sepse Afrika nuk është Evropa, dhe Nigeria nuk është Franca.

Disa Shkaqe të Thella të Skllavërisë

Sipas Papë Françeskut, “në rrënjën e skllavërisë gjendet një konceptim i personit njerëzor që pranon mundësinë që ai të trajtohet si objekt”. Dhe vazhdon duke thënë: “Kur mëkati e prish zemrën e njeriut dhe e largon prej Krijuesit të vet e prej të ngjashmëve të vet, këta të fundit nuk perceptohen më si qenie me dinjitet të barabartë, por shihen si objekte”, dhe kështu “privohet prej lirisë, tregtohet, kthehet në pronë të dikujt” dhe “trajtohet si mjet dhe jo si qëllim”. Këto janë pohime shumë serioze, së pari sepse tregojnë dekadencën e kulturës së sotme që, me gjithë përparime që ka bërë shoqëria në fushën shkencore, nuk arriti ta bindë njeriun se çdo person njerëzor ka një dinjitet dhe të drejta të pazëvendësueshme dhe që duhet të respektohet si person dhe kurrë si objekt. Së dyti, sepse tërheqin vëmendjen tonë të kuptojmë se vetëm besimi në Zotin krijues mund të shtrojë themelet për një etikë për rendin në shoqëri.

Pastaj Papa përmend varfërinë, nënzhvillimin, dhe përjashtimin, sidomos kur këto shoqërohen nga mungesa e edukimit dhe nga papunësia. Sepse, si

thotë Papa, shpeshherë viktimat e trafikut dhe të nënshtrimit janë njerëz të varfër që besojnë ata persona mashtrues dhe pa shpirt që u premtojnë punë jashtë shtetit. Kjo, mjerisht, ka ndodhur me shumë vajza shqiptare, të cilëve u premtuan punë të ndershme në ndonjë vend në Evropë ndërsa pastaj ishin të detyruar të shesin trupat e tyre në prostitucion.

Papa përmend gjithashtu korrupsionin si shkak skllavërie. Ka njerëz “që janë të gatshëm të bëjnë gjithçka për t'u pasuruar”. Fabrikantët e shumë formave të ndryshme të skllavërisë janë njerëz të pandërgjegjshëm dhe mizorë, personifikimet e shprehjes së Thomas Hobbes-it homo homini lupus – njeriu që bëhet ujk për njeriun. Këtu Papa përmend një parim që është përmendur qindra herë në doktrinën shoqërore të Kishës Katolike: “Në qendrën e çdo sistemi shoqëror apo ekonomik duhet të jetë personi”, dhe jo pasuria.

Si shkaqe të tjera skllavërie Papa përmend konfliktet e armatosura, dhunat, kriminaliteti dhe terrorizmi”. Besoj se nuk ka nevojë për asnjë koment mbi këto shkaqe, sepse jetojmë në një botë të mbajtur peng nga terroristët. Ndoshta kurrë në tërë historinë e tij njeriu nuk ka përjetuar aq shumë frikë ku nuk ndihet asgjëkund i sigurt.

Një Angazhim i Përbashkët

Këtu Papa thotë se duke vërejtur tregtinë e personave, trafikun e paligjshëm të migrantëve dhe format e tjera të skllavërisë, ka përshtypje se shkaku është mospërfillja e përgjithshme. Kur në korrik 2013 Papa shkoi në ishull Lampedusa, në atë det që është bërë varrezë për mijëra migrantësh nga Afrika, ai ka përdorur shprehjen “globalizimi i indiferencës”. Bota shikon, por pa marrë masat, pa marrë përsipër përgjegjësi.

Por njëkohësisht Papa përmend “punën e pamasë e të heshtur që shumë Kongregata rregulltare, sidomos femërore, çojnë përpara në dobi të viktimash”. Dhe këtu dëshiroj të shprehë kënaqësinë time e atyre Kongregatave të Motrave që janë shumë të angazhuara në punë për shpëtimin e shumë grave që në një mënyrë ose tjetër janë viktimat të personave pa shpirt që përpiqen t'i shfrytëzojnë. Gjithashtu përmend institucione katolike si Fondazione Mary Ward Loreto dhe sidomos Caritas Shqiptar me sektorin e antitrafikimit. Papa përmend veprimin e kongregatave rregulltare, që janë kryesisht: ndihma ndaj viktimave, rehabilitimi i tyre në profilin

psikologjik, dhe reintegrimin e tyre në shoqëri. Por thotë se nevojitet edhe një angazhim i trefishtë në nivel institucional, domethënë parandalim, mbrojtja e viktimave, dhe veprimi gjyqësor ndaj përgjegjësve.

Dhe këtu Papa flet për detyrat e autoriteteve civile. Shtetet duhet të hartojnë ligje që garantojnë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe të krijojnë mekanizma që sigurojnë zbatimin e këtyre normave që të mos i lënë hapësirë korrupsionit. Të gjithë e dimë se viktimat më të prekshme në një shoqëri të korruptuar janë njerëzit më të dobët dhe më të varfër: i pasuri ka mjetet për të korruptuar e kështu mund të fitojë çdo gjë.

Organizatat ndërqeveritare duhet të bashkëpunojnë për të luftuar rrjetet transkombëtare të krimit të organizuar. Ndërmarrjet duhet t'u garantojnë të punësuarve kushte pune të denja dhe rroga të përshtatshme. Ndërsa organizatat e shoqërisë civile duhet “të sensibilizojnë dhe të nxisin ndërgjegjet” për të çrrënjësuar “kulturën e nënshtrimit”. Por këtu mendoj se kanë një rol të veçantë dhe shumë të rëndësishme besimet e ndryshme. Sepse besimet mund të krijojnë strukturat, mund të ndryshojnë strukturat, por mbi të gjitha kërkohet ndryshimi i zemrës, dhe vetëm besimi mund të ndryshojë zemrën.

Afër fundit të mesazhit Papa Françesk përmend shembullin e një shenjtëreshe, Jozefina Bakhita, nga krahina e Darfurit në Sudan. Kur ishte 9-vjeçare u grabit nga trafikantët e skllavëve dhe iu shit pronarëve mizorë. Pastaj pati fat të lirohej dhe u bë murgeshë Kanosiane. Kjo shenjte, thotë Papa, është shembull shprese për viktimat e shumta të skllavërisë.

Mesazhi mbaron me një thirrje: që të gjithë ne të bëjmë “gjeste vëllazërore ndaj atyre që janë të mbajtur në gjendje nënshtrimi”. Të gjithë njerëzit vullnetmirë që janë dëshmitarë të plagës së skllavërisë bashkëkohore janë të thirrur “të mos bëhen bashkëpunëtorë të kësaj të keqeje” as të mbeten indiferentë, por të bëjnë çmos që t'u jepet viktimave dinjitetin e duhur, për të cilin kanë të drejtë. Dhe citoj fjalët e fundit të mesazhit: “Globalizimi i mospërfilljes, që sot peshon mbi jetët e shumë motrave e shumë vëllezërve, na kërkon të gjithëve ne që të bëhemi nismëtarë të një globalizimi të solidaritetit dhe të vëllazërisë, që mund t'u rihapë atyre shpresë dhe t'i bëjë të rimarrin me guxim ecjen nëpërmjet problemeve të kohës sonë dhe perspektivave të reja që ajo sjell me vete e që Hyji vë në duart tona.”

Don Pren Kola
Zvicër

FJALOR LITURGIK KISHTAR

(Pjesa e dytë)

(Shpjegime në aspektin e sakramenteve)

A (alfa). Gr. *Αλφα*. Shkronja e parë e alfabetit grek; simbol në disa shkenca (matematikë, astronomi, fizikë), që gjen përdorimin e vet edhe në liturgjinë e Pashkëve, pikërisht në përgjimin pashkor, për të shënuar Kishtin si të Parin dhe të Fundit, Fillimin dhe Mbarimin; shenjë për numrin 1, për një Hyji të vetëm; titull i Hyjit “Ai që është, që ishte dhe që po vjen, I Gjithëpushtetshmi”, për të bërë të ditur dhe vetë Krishtin në përjetësinë e tij si Fillimin dhe Mbarimin (krhs. Zb 1,8; 21,6; 22,13); shenjë të cilën, në vigjiljen e Pashkëve, ngulit prifti në qiriun pashkor bashkë me një omegë (shkronjën e fundit të alfabetit grek) dhe thotë: “Krishti dje dhe sot, fillimi dhe mbarimi i të gjithave, Alfa dhe Omega; atij i përkasin kohët dhe përjetësia, atij i qoftë lavdi dhe pushteti në shekuj të shekujve. Amen” (krhs. Zb 1,8). Alfa dhe omegë bëjnë të ditur se gjithçka ka pikësynim Krishtin, Hyji ka përqendruar veprën e vet në Krishtin, Ai është fjala e parë dhe e fundit e krenimeve tona liturgjike, gjithçka që bëjmë dhe veprojmë në

lavd e nder të Hyjit e bëjmë përmes tij; ai është Besëlidhja jonë e re dhe e amshuar me Hyjin (Lk 22,20; 1 Kor 11,25).

Buzm-i. Rit etnografik që bëhet me një kërcu të trashë, i quajtur dhe buzmi bujar, i cili vihet në zjarr natën e Krishtlindjes a Kërshëndellave, që prehet në mal ende pa zbardhur agimi dhe ndizet në mbrëmje dhe shtihet brenda pasi të ketë perënduar dielli; tërësia e një kremtimi familjar me shumë gjeste, fjalë dhe gjësende materiale (si dru, zjarr, bukë, djath, kungulluer e tjera) që bëhet sipas një rregulli të ngulitur në traditën shqiptare natën e Krishtlindjes sipas traditës shekullore në trevat shqiptare dhe me gjerë nëpër Evropë; ceremoni familjare shqiptare me drunj dhe zjarr me prejardhje pagane, që i paraprin festës së Krishtlindjes dhe tashmë bëhet në nderim të saj, me ç’rast përshëndetet dhe ushqehet druri sikur të ishte qenie e gjallë, dhe pastaj digjet tërë natën pa u shqimur, hiri dhe shkumbi i të cilëve hidhet nëpër të lashta dhe pemishte për të ndjellur korrje dhe vjelje të mbarë; rit popullor, i ruajtur deri më



tani në trevat shqiptare të krishterët, i cili, ndonëse, sipas studimeve etnozakonore shqiptare, ka zanafillë të festat dionisiake, ka përvetësuar përbërës të krishterë, si shenjë e kryqit, përshëndetjen me emrin e Krishtit dhe përmbajtje të tjera të krishtera; rit i kulturës materiale, shoqërore dhe artistike të shqiptarëve në vigjiljen e Krishtlindjes, në të cilin merr pjesë tërë familja (i madh e i vogël), që mbahet për të sjellë mbarësi, trashëgimi në djem dhe vajza, njomësi dhe begati; zakon i lashtë pagan, sipas gjasave parakrishteror, që mbahej, dhe ende mbahet pjesërisht jo vetëm të krishterët shqiptarë katolikë, por edhe të ata ortodoksë dhe islamë.

Hyji. Lat. *Deus*; gr. *Θεός*; heb. *El, Elohim*; arab. *Allah*, “Zot, Perëndi, Hyjni”. Qenia më e lartë dhe më e shenjtë e mbinatyrshe sipas përfytyrimeve fetare e mistike të religjioneve, mitologjive dhe besimeve, si dhe botëkuptimit metafizik, që ka krijuar botën, qëndron mbi të, e sundon dhe mban atë; qenia më e lartë (*supreme*) dhe objekti kryesor i besimit të njerëzve të gjitha kohërave, religjioneve, kombeve, gjinive, moshave dhe rangjeve arsimore, të cilës zakonisht i përshkruhet gjithëdituria (njohuria e pafund), plotfuqishmëria (pushteti i pakufizuar), gjithëprania (i pranishëm kudo), gjithëmirësia (mërësia e përsosur) dhe thjeshtësia hyjnore, ekzistenca e së cilës është e përvetshme dhe e nevojshme; Krijuesi, përkryermeritë e papashme, pushteti i amshuar dhe hyjnia e të cilit, atje që prej krijimit të botës, mund të shihen me anë të mendjes në saje të veprave të tij (krhs. *Rom* 1,20), që e shpalli vetveten në personin e Krishtit, në Fjalën e amshuar; qenia, e cila në kuptimin liturgjik, është gjithmonë vetë në veprim: ai ka krijuar botën, ai jep ushqimin dhe pijen për shijim; veta e parë hyjnore që ka dërguar Krishtin për shpëtimin e botës, ka thirrur vetë apostujt për të shpallur Ungjillin dhe drejton Kishën.

Shkrimi i Shenjtë tregon se çfarë është Hyji në vetvete: “Hyji është dashuri” (1 *Gjn* 4,8) dhe “Hyji është dritë” (1 *Gjn* 1,5). Vetitë më domethënëse dhe shenjat, përkatësisht cilësitë e Hyjit, të cilat shfaqen në Shkrimin e Shenjtë, janë: përjetësia (krhs. *Hab* 1,12; *Rom* 1,20), papashmëria (krhs. *Kol* 1,15), pavdekshmëria (krhs. *Ps* 90,2; 1 *Tim* 1,17), Gjithëpushtetësia (krhs. *Job* 24,1; *Mt* 19,26; i vetmi Sundimtar 1 *Tim* 6,15), gjithëpranishmëria (gjithkundshmëria: krhs. *Ps* 139,7–10; *Jer* 23,23–24), gjithëdituria (krhs. 1 *Kro* 28,9; *Is* 42,8; *Rom* 29,30; *Heb* 4,13), pashkatërrueshmëria (krhs. *Rom* 1,23; *Jak* 1,13), pandërrushmëria (krhs. *Mal* 3,6; *Jak* 1,17), urtia (krhs. *Ps* 104,24; *Rom* 11,33–36), shenjtëria (krhs. *Ps* 47,9; 99,3–5; *Zb* 4,8), drejtësia (krhs. *Ps*

89,15; 2 *Tim* 4,8), hiri (krhs. *Ps* 136; 2 *Kor* 1,3; *Ef* 2,4), duresa (krhs. *Dal* 34,6; *Rom* 9,22), besnikëria (krhs. *Ps* 36,6; *Heb* 10,23). Në kremtimet tona liturgjike, përmes Krishtit, Shpëtimtarit dhe të Zgjedhurit të Trinisë së Shenjtë, ne përnderojmë dhe falënderojmë Hyjin që është shpirt (krhs. *Gjn* 4,24), dritë e dashuri (krhs. *Jak* 1,17; 1 *Gjn* 4,8), i papashëm dhe i pavëzhgueshëm (*Ps* 145,3; *Rom* 11,33), i amshuar dhe i pavdekshëm (krhs. *Ps* 90,2; *Zb* 4,8–10; 1 *Tim* 1,17; 6,16), i gjithëpushtetshëm dhe gjithkund i pranishëm (krhs. *Zan* 17,1; *Dal* 6,3), i pandërrueshëm dhe gjithëdijshëm (krhs. *Ps* 102,27–28; *Rom* 16,27), i madhërueshëm dhe i tejtejlartë (krhs. *Dal* 15,11; *Ps* 83,18; *Vep* 7,48), i përsosur dhe i shenjtë (krhs. *Mt* 5,48; *Ps* 99,9), i drejtë dhe i vërtetë (krhs. *Lp* 32,4; *Gjn* 17,3), i saktë dhe i dhimbshëm (krhs. *Ps* 25,8; 92,16; *Es* 9,15), i mirë dhe i madh (krhs. *Ps* 25,8; 119,68; *Ps* 86,10), i mëshirshëm e besnik (*Dal* 34,6; *Ps* 116,5; 1 *Kor* 10,13, 1 *Pjt* 4,19), i gatshëm për ndjesë dhe durimmadh (krhs. *Dal* 34,6–7; *Ps* 86,5; *Num* 14,18). Hyji kërkon prej nesh që ta adhurojmë në shpirt e në të vërtetë (krhs. *Gjn* 4,24). Ne e adhurojmë Hyjin përderisa nuk dyshojmë në premtimin e tij (krhs. *Rom* 4,20), përderisa e pranojmë Krishtin dhe dëshmojmë se Jezu Krishti është Zot (krhs. *Fil* 2,11), përderisa vuajmë për të dhe madhërojmë emrin e tij (krhs. 1 *Pjt* 4,14,16; *Vep* 19,17).

Liturgjia e krishterë, si veprim i popullit, si shërbim i hapur, i dukshëm dhe gjallërik i Kishës, kryhet në nder e lavd të një Hyjit të vetëm në tri vetje hyjnore, Trinisë së Shenjtë, ashtu siç e shpall Bibla dhe dëfton Jezu Krishti. Shih Zoti, Perëndia, Hyjnia.

Nun-i. Lat. *patrinus*, “dorëzan”; *levans*, “përkrahës”; *levare*, “peshoj në duar, mbart”. I zgjedhuri i familjes dhe i miratuari i Kishës, i cili barte në duar foshnjen gjatë pagëzimit dhe, përpos dëshmisë që bën në këtë sakrament, zotohet të përmbushë detyrimet që merr përsipër sipas ligjit kishtar, që së bashku me prindërit t’i bëhet fëmijës dëshmitar i fesë dhe ta udhëheqë në jetën e krishterë; shërbesë nderi me zotim në sakramentin e pagëzimit para Kishës, duke marrë mbi vete edhe përgjegjësi që fëmija të edukohet në fenë katolike dhe, ngjan që, sipas traditës sonë kombëtare, ia vë edhe emrin fëmijës dhe bëhet në vazhdimësi mik dhe dashamir i familjes; kumbarë që, sipas traditës shqiptare, i merr flokët fëmijës së porsalindur, dëshmon në sakramentin e krezmimit dhe vë dorën e djathtë mbi supin e famullit, përkatësisht të atij që po krezmohet, ndërsa në kurorën martesore në kishë është dëshmitar. Nuni dhe nuna, që kanë origjinë që nga

shekulli II i krishterimit, është figurë qendrore në fenë e krishterë, sepse ndihmon familjen e famullit ose famulleshës në sakramente të caktuara nga Kisha dhe, hyn dorëzan, zotohet se do të veprojë ashtu siç kërkohet prej tij. Nuni dhe nuna zgjidhen nga vetë famulli, nëse është i rritur, ose nga familja, ose, nëse familja mungon, nga famullitari që kryen pagëzimin, dhe duhet të ketë mbushur 16 vjet, të jetë katolik e të ketë marrë sakramentin e Eukaristisë, të ketë një jetë sipas parimeve krishterore dhe të mos jetë nën ndëshkimin e dënimeve kanonike. Nun dhe nunë në pagëzim mundet të jetë edhe një pjesëtar i pagëzuar në një tjetër bashkësi kishtare, por vetëm së bashku me një nun katolik, dhe në të vërtetë vetëm si dëshmitar (krhs. *CIC*, 872–874). Me rendin e ri të shërbesës së nunërisë së pagëzimit të fëmijëve (1969), janë prindërit ata që bartin vetë fëmijën para duarsh gjatë pagëzimit dhe përgjigjen në pyetjet e Kishës. Nuni vë vetëm dorën e djathtë sipër famullit, përkatësisht foshnjës që pagëzohet, ndërsa dorën e djathtë mbi syrin e djaloshit ose vajzës që krezmohet. Në popullin tonë nuni i pagëzimit e përcillte famullin ose famulleshën edhe përmes krezmimit e deri te kurorëzimi, por rregullisht nuk duhet identifikuar nunin e pagëzimit me atë të krezmimit dhe as me dëshmitarin në kurorë.

Pagëzim-i. Lat. *baptismus*. Sakrament themeltar i tërë jetës së krishterë përmes të cilit marrim dhe të drejtën e pranimit të sakramenteve të tjera që së bashku me krezmimin dhe Eukaristinë kanë karakter të njësishtëm dhe, në Kishën katolike, janë të nevojshëm për plotësinë e fillesës së krishterë (krhs. *KKK*, 1213; *CIC* 842); pikënisje e shenjtërimit, me anën e të cilit të pagëzuarit mishërohen në Jezu Krishtin dhe në Kishën katolike, caktohen për kultin e krishterë dhe marrim detyrim të dëshmojnë haptazi fenë e marrë prej Hyjit nëpërmjet Kishës, bëhen bijtë e Hyjit, bashkëpjesëmarrës të natyrës hyjnore dhe pranojnë shenjtërinë (krhs. *LG*, 11, 40); sakrament i nevojshëm për shpëtim në Jezu Krishtin që hap derën dhe krijon bazën për sakramente të tjera në Kishën katolike dhe në kishat e tjera simotra, me anë të të cilit shlyhet mëkati i trashëguar a i rrjedhshëm (mëkati i Adamit dhe

Evës) dhe mëkatet e tjera personale kur ndonjëri pagëzohet në moshën madhore; sakrament i ripërtëritjes dhe trupëzimit në bashkësinë e Kishës, i kthimit dhe i faljes së mëkateve, me ç'rast i pagëzuari merr dhe dhuratat e Shpirtit të Shenjtë (krhs. *Vap* 2, 28; *1 Kor* 6, 11; *Ef* 5, 26); veprim liturgjik sakramentor që ka ruajtur formën e plotë me pak ndryshime edhe në kishat lindore dhe zbatohet në Kishën katolike përmes derdhjes së ujit mbi kokën e foshnjëve ose të të rriturve, përmes zhytjes së tërë në burimin e pagëzimit, kërrosjes së pjesshme, si dhe stërpikjes në Kisha të tjera; shenjë e shenjtë e hirit dhe e shpëtimit e cila qysh në Kishën e hershme filloi të zbatohet në vigjiljen e Pashkëve, dhe tanimë porositet nga Kisha katolike së paku në ditën e diel, dhe kryhet e bëhet vlefshëm vetëm përmes ujit dhe fjalëve: “Unë po të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shenjtë”; sakrament i fillesës së krishterë përmes të cilit në pikëpamjen katolike i bën të pagëzuarit pjesë të popullit të Zotit (krhs. *PO*, 4) dhe, për nga natyra e shërbimit, i përket ta zbatojë ipeshkvi, të cilin që nga Kisha e hershme e ndihmonin diakonët dhe priftërinjtë, por që sot i ngarkohet si detyrë e veçantë priftit (krhs. *CIC*, 530), ndërsa ipeshkvit i është ruajtur e drejta e pagëzimit të të rriturve. Në rast nevojë të ngutshme mund të pagëzojë gjithsecili njeri, qoftë edhe i ndonjë feje tjetër, por me kusht që të ketë qëllimin të kryejë atë veprim që kryen vetë Kisha (krhs. *CIC*, 861-863). Pagëzimi krijon bazën e njësisë të të gjithë të krishterëve edhe pa pasë qenë ata tërësisht të bashkuar me Kishën katolike (*KKK*, 1271), sepse “ata që besojnë në Krishtin dhe kanë marrë pagëzimin në mënyrë të vlefshme, formojnë njëfarë bashkësie, edhe pse jo të përsosur, me Kishën katolike” (UR, 3).



Don Nosh Gjolaj
Podgoricë

MIRËNJOHJA E TË DREJTËS - SHOKUT TË MARTESËS

Pjesa e parë

1. T'i njohësh të drejtat e tjetrit pa kushte

Bashkësia njerëzore nuk është vend i eksperimentimit, aq më pak bashkësia martesore. Nganjëherë në bashkësinë martesore bëhen gabime të rënda dhe lëshime të papërmirësueshëm, nëse tentojmë ta provojmë qëndrueshmërinë e partnerit. Një gjest i tillë nuk është asgjë tjetër përveç një paragjykim i trashëguar që ia kemi lejuar vetes. Nga mendjelehtësia, jo rrallëherë nguliten thashetheme në nënvetëdijen apo pavetëdijen tonë. Zakonisht çifti i përdor këto shprehje: “Partneri i im më do, ai e ka dëshmuar veten, posa ka vendos të jetojë me mua! Po ashtu edhe unë jam e vetmja që ia kam rrëmbyer zemrën e tij!” Shpeshherë pikëpamjet e tilla të gabuara të një filozofie primitive do t'i kushtojnë shumë çiftit martesor. Në këtë rast, sipas tyre, qëllimi i jetës është për t'i pëlqyer dhe për t'ia nënshtruar vullnetit tjetrit, dhe ai tjetri do të flijohet krejtësisht si fli e nënshtrimit. Siç e kemi theksuar, pikëpamje të tilla janë të gabuara edhe fatale, të mos themi vdekjeprurëse për çiftin martesor. Martesa si martesë nuk mund të jetë qëllim në vetvete, po ashtu as partneriteti mes dy partnerëveve. Martesa, si e tillë, supozon konkretizimin dhe aktualizimin e dashurisë, që është edhe detyra kryesore. Nëpërmes

institucionit të martesës është edhe ardhmja e botës, e kombit, e shtetit dhe e Kishës. Përndryshe bashkësia martesore do të ishte laborator i eksperimenteve, që do t'i sillte njeriut jo vetëm shkatërrimin e bashkësisë martesore, por edhe të gjinisë njerëzore. Pikëpamjet e gabuara nuk janë asgjë tjetër përveç paragjytime që rrjedhin nga politika e ditës. Dhe qartas shihet ajo dozë e kufizimit dhe vetëmbrojtja e një egoizmi, në të cilin dëshirojmë ta themelojmë bashkësinë martesore, por në themelin e supozimit dhe të eksperimentimit, për ta realizuar veten (egoizmin) përmes tjetrit, i cili nënshtrohet dhe bëhet objekt. Në qoftë se njëri prej partnerëve i nënshtrohet tjetrit në mënyrë të plotë dhe tërësish, ai jo vetëm se e humb unin (veten) duke u shkrirë në tjetrin, por mbet invalid dhe gjysmak i çoroditur apo i çrregulluar për tërë jetën e përbashkët. Ne nuk jemi në gjendje t'i nënshtrohemi tjetrit dhe të shkrihemi në tjetrin, këtë nuk guxojmë as ta mendojmë fare, as për hir të martesë, as për hir të dashurisë, as për hir të mjedisit, as për hir të kërcënimit. Sepse një martesë e tillë, e cila programohet për ta eksperimentuar tjetrin, aty pikërisht në individin e nënshtruar, do të akumulohet ajo energji negative dhe më vonë edhe shpërthyes, e cila më vonë do të realizohet në refleksin mbrojtës, në rrafshin instiktiv, dhe ashtu fillon ta realizojë



vetveten dhe egoizmin jashtë bashkësie, do të thotë jashtë kurorës martesës. Fjala bie, një grua që e ka burrin tiran apo autokrat (të ashpër), ai do t'i rrisë fëmijën e huaj, edhe pse gruan e ka të lidhur me zinxhirët e hekurit. Këto do t'i ndodhin spontanisht, pa u vërejtur fare.

Partnerët duhen t'i kundërvihen me gjitha forcat dhe mundësitë që kanë çdo lloj tjetërsimi, për ta ruajtur individin tjetër ashtu siç është. Përndryshe, kur të vetëdijesohemi, shumë lehtë mund të befasonemi, kur e shohim se vapor i martesë e ka marrë një drejtim tjetër. Sepse bashkëshortit nuk u përmbahen më atyre fjalëve fillestare, që ia kanë premtuar njeri-tjetrit për dashuri dhe besnikëri, përpara martesës. Atëherë kur t'a arrijnë vetëdijesimit, do të sillen si histerikë, të hutuar dhe e humbin tokën nën këmbë duke fajësuar tjetrin: "Tani nuk më do më! Më ke tradhtuar! Egoist i poshtër, i pafytyrë etj.!" Në qoftë se në mënyrë të psikanalizës analizojmë nënshtrimin dhe arsyet e saj, shumë shpejt do ta shohim se strehimi në gjirin e bashkësisë martesore nuk ishte asgjë tjetër përveç dëgjueshmëria absolute ndaj tjetrit. Gabimi fatal do të ishte po qe se qëndrojnë edhe më tutje, në një bashkësi të tillë. Për të dalë jashtë nga ky burg i tmerrshëm duhet vetëdijesimi i dy palëve, si ai që nënshtron tjetrin ashtu edhe i nënshtruar. I pari duhet ta pranojë se i ka uzurpuar të drejtën e vetëvendosjes bashkë partnerit, duke mos respektuar pjekurinë personale si dhe përgjegjësinë por në të kundërtën ia ka gropuar tokën nën këmbë, ku ka rënë edhe vetë. I dyti të vetëdijesohet se njeriu është person unik, që nuk bën të shkrihet, as të asgjësohet në tjetrin, as për hir të dashurisë, as për hir të askujt, por duhet të mbesë individ edhe më tutje, me të gjitha tiparet e dhuruara, por kuptohet se duhet dita-ditës të fisnikërohet në rrugën e përbashkët me tjetrin.

Partnerët duhet ta kenë të qartë, se çdo njeri e ka të drejtën e punës dhe pas punës së rëndë të jetë i (e) lodhur. Kishte me qenë shumë, të mos themi primitive, në qoftë se njëri prej partnerëve e fajëson tjetrin, se gjoja nuk e do. Ai ose ajo duhet ta kuptojë se puna e rëndë i ka ligjet e veta, dhe pas punës trupi dhe shpirti kërkon pushim apo relaksim. Vetvetiu kuptohet se individ i tillë nuk mund të shkojë me shokun martesor në vallëzim, në teatër, në opera, në kinema ose në ndonjë argëtim tjetër. Një kriter i tillë, nuk është asgjë tjetër përveçse vlerësim i njëanshëm, duke zbuluar egoizmin vetjak dhe shfrytëzues.

Po ashtu çdo njeri ka të drejtë të pushojë, qoftë në pushimin e ditës, të javës, apo atë vjetor. Kemi të drejtë edhe për një qetësi, heshtje për t'u tërhequr në

vetmi, në meditim, në ushtrime shpirtërore etj.. Madje kuptohet edhe e drejta për të ngrënë deri sa nuk ngihemi. E drejta për të disponuar atë pronë, të cilën e kemi fituar me punën personale. Mos të flasim për drejtat personale, që janë në shërbim jo vetëm të vetes por edhe bashkësisë martesore si dhe shoqërisë më të gjerë, siç janë mes të tjerave edhe specializimet, si në lëmin profesional, intelektual, apo praktik. Të njëjtat të drejta i ka dhe i duhen lejuar edhe partnerit tonë martesor, në qoftë se dëshirojmë të jemi fatlumë dhe në harmoni njëri me tjetrin dhe në këtë mënyrë bashkësia martesore bëhet vatër jo vetëm e ngushëllimit dhe e akumulimit, në të cilën mbushet akumulatori i zbrastë, por edhe i dashurisë, që me siguri do të shpërblejë shumëfish si njërin partner, ashtu edhe tjetrin.

Në qoftë se njëri prej partnerëve e kërkon të drejtën vetëm për vete, përderisa tjetrin e ngarkon me detyrime të shumta, posaçërisht nga fryma e paragjytimeve: siç janë ato pikëpamjet e errëta apo të verbëta, trashëguar nga e kaluara, se ashtu ka jetuar babai dhe babagjyshi dhe, ku jam unë më i mirë se të tjerët! Në anë tjetër një gjest i tillë edhe i pëlqen për ta mbrojtur egoizmin dhe pasigurinë e tij. Por shumë shpejt do të ballafaqohet me pasoja tragjike dhe vdekjeprurëse, që jo vetëm e shkatërron bashkësinë martesore, por edhe e helmon veten dhe tjetrin. Po qe se edhe takohet me një grua, e cila është e formuar dhe e edukuar me frymën e dëgjueshmërisë dhe të shërbesës, atëherë rreziku është edhe më i madh, sepse gruaja e tillë do ta marrë mbi vete shërbesën si një barrë apo ngarkesë e natyrshme, sepse ashtu është fati i saj, si femër, (i shkruar prej Zotit). Në mënyrë të pavetëdijshme ajo i dorëzohet fatit edhe kundër dëshirës e vullnetit. Pas një kohe nënshtrimi, fillon të shpërthejë refleksi mbrojtës. Konflikti i madh i brendshëm është i pashmangshëm. Dëshirat dhe liria e humbur sumplimohen në skajshmin tjetër, në rastet e shumta realizohet, jo si një dëshirë seksuale, por më tepër, si një farë pasioni dehës për epshin seksual, te disa arrin deri te dashuria e nimfomanisë (fjala nimfomania buron prej fjalës greke nymfe, që në mitologjinë greke janë pamjet e fuqive të natyrës, si ato nimfat e pyllit, nimfat e detit, e nimfat e bjeshkës, nimfat e lumenjve, që ishin vajzat e bukura, që në gjuhën e shqipe quhen "flokçi"), e cila fillon të vuajë nga pangopësia seksuale, që do të realizohet në mënyrat e llojllojshme që nga postieri deri në çdo lloj tipi, me të cilin takohet. Sepse seksi i tillë është vetë nga natyra jo spontan dhe i natyrshëm, por më tepër mund ta quaj "erotika e çoroditur". Nimfomania është sëmundje e quajtur pangopësia seksuale e një femre,

kurse të meshkujt e quajnë satirijazmi, që lajmërohet veçanërisht tek njerëzit e sëmure psikikë, oligofrenët, të fillimi i paralizës progresive. Fikjn e epshit seksual në të kundër e quajmë frigjiteti të femrat dhe impotencia të meshkujt. Madje lajmërohet tek të sëmuret neurotikë, si ata që vuajnë nga depresion apo skizofrenia, madje këtë dukuri e hasim edhe tek narkomanët dhe posaçërisht të alkoolikët.

2. Si ta “humbësh” apo ta mposhtesh veten - egon

Nga natyra njeriu është egoist. Në jetën e përditshme sheh vetëm veten dhe problemet që e ngarkojnë, ndërsa tjetrit nuk e sheh. Nëse e sheh, atëherë e sheh veten nëpërmes tjetrit, sepse ai tjetri është pasqyre ku e sheh veten. Po ashtu nuk është i aftë që t'i përgjigjet kërkesave dhe nevojat të kohës. Njeriu egoist është mjaft i varur nga bota materiale për ta plotësuar zbrazëtinë e brendshme. Ai mendon se nëpërmjet mirëqenies materiale do ta krijojë atë siguri që i mungon. Jo vetëm kaq, por që ta mposhtë varësinë dhe pasigurinë e brendshme, lufton pa kompromis, të mos themi në mënyrë arrogante dhe vulgare, për t'i krijuar vetes mirëqenien materiale, siç është ushqimi, veshmbathja, standardi jetësor, puna dhe punësimi, posaçërisht kënaqësia e nevojave hedoniste, jo vetëm seksuale por edhe e kënaqësive të tjera, qofshin trupore apo shpirtërore. Para vetes qëndron si pasqyrë hedonizmi dhe kërkesat për ta kënaqur brendinë e zbrazët, përmes së cilës zbulohet pasiguria dhe varfëria e brendshme. Posaçërisht në varfërinë dhe pasigurinë e tij ndikon filozofia e ditës materialiste. Ai do të sillet sipas diktimit të politikës së ditës. Diktimi i tillë është mjaft i vrazhdë dhe i tmerrshëm, sepse çdo ditë sjell brengën e vet, e cila edhe kushtëzon mirëqenien materiale dhe fizike, të mos flasim për sjelljen etiko-morale, e cila e shpie deri te humnera e shkatërrimi të plotë të qenies apo bërthamës së vet. Më lehtë do t'i kuptojmë njerëzit e tillë, që i tundon mashtrimi materialist, që e shpëput nga baraspesha normale e jetës, të mos flasim për pamundësinë për t'u pavarësuar. Për t'u çliruar nga kjo provë negative, e cila zakonisht e ka zanafillën në moshën e njomë të fëmijërisë, individit duhet të korrigjohet dita-ditës për ta marrë atë modelin e një njeriu të pavarur me unin e vet, që ai t'ia diktojë vetes ritmin e jetës.

Zakonisht ata njerëz, të cilët e mposhtin frikën, ankthin dhe dalin fitimtarë të përmbajtur, mësohen me kohë që t'i ruhen nga modelet stereotipe, që dikton politika e ditës. Përderisa ata, të cilët gjithëherë humbin, hap pas hapi i ndjek disfatën, dhe zakonisht marrin një model jete, në të cilën edhe lidhet dhe varet

nga modeli, se pa të as nuk mund të ekzistojnë. Me qenë paradoksi edhe më i madh, ata flasin mbi vetë, posaçërisht e paraqesin veten si njerëz të suksesshëm, por fatkeqësisht në rastet e shumta janë të luhatshëm, të pavendosur, të pasigurt në vetvete; po ashtu janë të vetëdijshëm se kanë rënë në kurthin materialist dhe si të tillë e përjetojnë fatkeqësinë e jetës. Derisa të tjerët flasin për vetë, me pikëpamje negative dhe pesimiste, kinse janë njerëzit e dështuar dhe të humbur, dhe si të tillë nuk kanë ndonjë plan apo perspektivë apo qëllim jete. Me një fjalë janë të paafte për të ecur përpara, të mërziur dhe të lodhur në mesin e rrugës, pothuaj janë të vdekur, por kanë mbetur kufoma të gjalla që ende vegjetojnë. Nuk janë as të vetëdijshëm, se në rastet e shumta, ia krijojnë vetes burgun e tmerrshëm, duke ia çelur gropën tjetrit dhe bien vetë në të. Dhe të mos flasim për bezdinë dhe mërzinë që ia krijojnë vetes.

Njeriu i cili e humb baraspeshën e jetës duke përjetuar disfatat njëherë pas tjetrës, rrallëherë, është i aftë për ta jetuar kohën e sotme (të tashmen). Frustrimi është aq i madh, saqë nuk mund të shpëputet nga e kaluara, përderisa e ardhmja e godet rëndë, duke i sjellë pasigurinë. Të mos flasim pastaj për frikën dhe ankthin që e shoqëron, dëshpërimin dhe pesimizmin e jetës dhe si i tillë e humb çdo vullnet për të ardhmen. Ngel dhe jeton kohën e kaluar, duke ëndërruar atë kohën e bukur që ishte dikur. Kur i potencon vështirësitë dhe pengesat e dikurshme, edhe më tepër e kaplon ankthi, frika e pasigurisë, sepse edhe sot do të humbë duke përjetuar disfatën e dikurshme. E humb edhe atë fuqi që e zotëron e kotësinë e të kaluarës dhe e kaplon njëfarë hidhërimi, nervozizmi. Kur flet, gjithnjë qahet, duke fajësuar tjetrin, duke mos e marrë përgjegjësinë mbi vetë.

Karakteristika e njerëzve të tillë shprehet edhe në përluljen e tjetrit, për ta ngritur veten. Pothuaj gjithëherë arsyetohen dhe njëherazi e jeton kohën e kaluar: “Po të isha martuar me dikë tjetër...”, “Po të kisha kryer studimet...”, “Po të kisha qenë e bukur...”, “Po të mos pinte burri im...”, “po të isha i pasur...”, “po të kisha pasur prindërit e mirë...”

Personi, i cili jeton kohën e kaluar, vetëm ëndërron eventualisht ndonjë mrekulli, që do ta bënte fatlum, dhe të kënaqur. Ai e humb kohën e çmueshme në botën e ëndrrave dhe për zgjedhjet magjike: “si do të jetë bukur...”, “kur do të vijë princi në kalin e bardhë, ose gruaja ideale...”, “kur do t'i përfundoj studimet...”, “kur do të rriten fëmija...”, “kur do të filloj me punën e re...”!

Përderisa disa persona jetojnë në iluzionin e zgjidhjes magjike, të tjerët jetojnë në frikë të përhershme nga mundësitë e katastrofës.

Imagjinojnë dhe presin: "Çka do të bëhet në qoftë se..?" "Çfarë do të ndodhë me mua nëse e humb punën...?" "A do të çmendem nëse kam gjakderdhje...?", "në qoftë se vërsulem në frontin e luftës...?", "po qe se nuk do t'i pëlqej..?", "nëse bëj ndonjë gabim...?" etj..

Kemi edhe njerëz të tillë, të cilët nuk e jetojnë jetën e përditshme, realitetin që e sjell e sotmja, por janë gjithnjë të ngarkuar me të nesërmen, çfarë do t'u sjellë e ardhmja dhe zakonisht e kalojnë tërë jetën në ankth dhe frikë. E tashmja e tyre është e ngarkuar me imagjinatën e bujshme, që zakonisht ndërlihet me ngjarjet e të kaluarës, po qe se ka pasur edhe ndonjë disfatë, këtë do ta reflektojë në ato ndodhitë e të ardhmes. Si fjala vjen, detyrat, të cilat duhen të kryhen, llogaritë e llojllojshme të cilat duhet të paguhen, marrëdhëniet e ndërsjella në dashuri, kriza, sëmundja, meditim, koha etj.. Imagjinata e bujshme vepron në kohën e tashme për ato veprime që i imagjinojnë se do vijnë nesër, ndërsa e përditshmja i rrëshqet nga duar dhe mbetet duarzbrazët, duke mos e pasur të ardhmen në zotërim. Në këtë rast nuk është asgjë tjetër, përveç frika, pasiguria ndaj vetes, që i pengojnë për t'u ballafaquar me realitetin e përditshëm. Të mos flasim për individin e tillë, i cili nuk është fare i aftë për ta vëzhguar jetën e përditshme, ai nuk e sheh as personin me të cilin jeton, as nuk e dëgjon, as nuk e ndien, as nuk e sprovon, as nuk e prek, madje ata nuk e mendojnë fare në mënyrë sistematike dhe të tërësishme për realitetin e përditshme.

Njeriu, i cili e humb pikëpamjen e jetës, zakonisht bëhet i paafte për ta kuptuar realitetin e tashëm dhe mundësitë e veta. Vërtet, ata bartin syzet e ngjyrosura dhe gjithçka shihet, e shohin, shihet nëpërmes syzeve të ngjyrosura me pesimizëm të mos themi të çoroditur, jo vetëm si pengon për t'u kacafytur me realitetin e jetës por edhe për t'u korrigjuar.

Mos të flasim për njeriun, i cili gjithherë përjeton disfatat, njëherë pas tjetrës, ata shumë lehtë behën edhe fli, gjysmak pa unin e fortë por të luhatshëm. Atë frikën apo pasigurinë e ndërlihin në arkëtimin e jetës, ose simulojnë, manipulojnë dhe i stërmadhojnë rolin e dikurshëm, që ka zanafillën nga mosha e fëmijërisë. Energjinë vitale, që e posedon rastet e shumta e shkapërderdh në veprimet e panevojshme, siç fjala bie, ikja prej vetvetes dhe fshehët nëpër

maskat e llojllojshme, apo vetes ia ven stolit e fytyrës, për ta shprehur pamjen tjetër, ashtu siç ai dëshiron me u duket para tjerëve dhe jo realitetin ashtu siç është. Sipas Karel Horney-i, ata gjithherë janë në veprim për ta ndërruar pamjen reale, duke u paraqitur para tjerëve ashtu siç u thotë mendja. Kamufliimi është mjaft i varfër dhe pa ndonjë përmbajtje. Në rastet e shumta e takojmë tipat e tillë, te individët e tërhequr. Si shkaktar është disfata apo humbja gjatë jetës, tani ata vetëm simulojnë botën jo reale, sepse këtë e kërkon nevoja e botës së brendshme. Vetvetes nuk ia lejojnë për t'u realizuar si person, edhe pse para vetes është spektri i gjerë i jetës. Pothuaj se janë të verbër dhe fare nuk shohin ndonjë mundësi për ta realizuar qëllimin e jetës. Karakteristika e njerëzve të tillë është edhe frika nga çdo lloj noviteti, për këtë ata me këmbëngulje luftojnë për ta ruajtur "status quo". Në anë tjetër ata e bartin zharg "thasët e mbushur" nga fëmijëria, duke i përsëritur herë pas herët. Mos të flasim për mungesat familjare dhe kulturës personale. Personi i tillë shumë vështirë do t'i shprehin ndjenjat e brendshme, po ashtu nuk tregohet i natyrshëm në marrëdhëniet intime, fare nuk është i çelur apo i hapur ndaj tjetrit dhe i mungon spontaniteti. Nga tjetri pret që t'ia përmbushin dëshirat, përderisa ai vetën nuk është racional, duke i shkapërderdhur energjinë për ta kënaqur tjetrin.



BARI SHPIRTEROR QE MPOSHTI DIKTATURËN

Përkujtohet 35 vjetori i vdekjes së Imzot Ernest Çobës.
1912-1980

Me 8 janar 1980, vdiq në burg dëshmitari i fesë së krishterë, kryepeshkvi Shkodrës, imzot Ernest Çoba, pasi, megjithëse me natyrën e butë që kishte, e dëshmoi me heroizëm të pasqorë Jezui Krishtin, duke pësuar për këtë arsye tortura mizore, që ia shkurtuan edhe jetën tokësore. U bë kështu model për të krishterët e grigjës shpirtërore që i qe besuar nga Kisha.

Kryepeshkvi imzot Ernest Çoba, lindi më 16 shkurt 1912 në një familje të vjetër qytetare shkodrane. Mësimet e para e ato të mesme i kreu në Seminarin Papnor në Shkodër. U shugurua meshtar më 9 shkurt 1936. Si prift kreu detyra të ndryshme pranë seminarit papnor, ku ishte përgatitur. Shërbeu edhe si mësues i besimit ndër shkollat e qytetit.

Pas vdekjes së kryepeshkvit imzot Thaçit dhe arrestimit të dom Mikel Koliqit, dom Ernest Çoba kreu njëherësh detyrën e zëvendës-famullitarit e të famullitarit Katedrales së Shkodrës. Ishte një nga ipeshkvijtë që u shugurua në kohën më kritike për Kishën katolike në Shqipëri, kur nga regjimi komunist bëheshin përpjekjet për ta shkëputur nga Selia e Shenjtë e Vatikanit. I vetmi ipeshkëv katolikë shqiptar që ishte ende gjallë e jo në pranga, imzot Bernardin Shllaku, e shuguroi imzot Ernestin, së bashku me ipeshkvin e Durrësit, imzot Pjetër Demën më 20 prill të vitit 1952. Vishte paramentet liturgjike (veshjet liturgjike për kremtime të ndryshme të sakramenteve) me ngjyrë të kuqe, në kohën kur kjo ngjyrë, së bashku me gjakun e Shpëtimtarit të njerëzimit, Jezui Krishtit, simbolizonte edhe gjakun e sivëllezërve të tij, që derdhej pa kursim ndër zaje të shkreta. Imzot Ernest Çoba merrte në duar një mision, që i ngjiste shumë misionit të ipeshkvijve të parë të krishterimit, të cilët shumë shpesh e bënë më të theksuar të kuqen e petkut të tyre, duke e ngjyrosur me gjakun e derdhur amfiteatrove për t'i qëndruar besnikë Krishtit, Ungjillit dhe Zëvendësit të tij mbi tokë, Papës së Romës.

Pak kohë pas shugurimit të tij, imzot Shllaku vdiq. Dioqeza e Shkodrës, që mbas shkëputjes nga dioqeza e Tivarit, kishte pasur shumë ipeshkvij të mëdhenj si imzotët Karl Pooten, Pashko Guerinin, Jak Serreqin, Lazër Mjedën e Gaspër Thaçin, mbeti ndër duart e ipeshkvit të butë, të ëmbël, simbol i gjallë i dashurisë së krishterë, në udhëheqje të imzot Ernest Çobës.

Ja si e përshkruan figurën e tij ipeshkvi ndihmës i Shkodrës, imzot Zef Simoni në librin e tij

"Portrete klerikësh katolikë": Imzot Ernest Çoba "

Kishte trup të shkurtër, sy të shkathët, gjysmë të fshehur mbas syzeve të errtë kur shërbente në kishë apo në zyrë. Kishte cilësi të mira: ishte i përvujtë, kryeulur, i qetë, i matur, i palodhur në shërbime, deri ndër ato që nuk i përkisnin si ipeshkëv. Monsinjori gjendej çdo ditë, mbasi kremtonte Meshën e orës 6, mbi krye të sëmureve të qytetit, ndër kolibe, tu çu sakramentet shenjte, ndërmjet fëmijëve në orë katekizmi masiv, kur Kisha e madhe gumëzhinte nga



zërat femërore. Kjo bëri të fitonte popullaritet të madh e simpati, sidomos ndërmjet të varfërve.

Qe drejtues i shoqërisë së Kryqtarëve të vegjël pranë etërve jezuitë, njohës i tri gjuhëve të huaja, specialist i teologjisë morale dhe i lëndëve të besimit, e jo ma pak, meshtar praktik në punët e fesë e të liturgjisë.

Nuk arriti të merrte pjesë në vitin 1962 në Koncilin II të Vatikanit por, me largpamësinë e tij, beri të depërtojë fryma e Koncilit kishtar në gjithë jetën e Kishës. Pati guximin të mbledhte një grup dëshmitarësh për rrugën e meshtarisë dhe të shuguronte shatë prej tyre, ashtu si dhe guximin të mbante lidhje të ngushta me Selinë e Shenjtë, duke shfrytëzua të gjitha mjetet dhe rrugët e mundshme".

Në prag të mbylljes së Kishave në Shqipëri nga regjimi komunist, në një të diele të hidhur, ndërsa ishte thirrur që të akuzohej, u kthye në akuzues, duke mbajtur një fjalim të zjarrtë, që i ngjiste pretkut, për të mbrojtur Zotin e sulmuar, Kishat e tempujt fetar në prag të rrënimit të madh.

Megjithatë, jo shumë kohë më vonë dyert e Kishave do të mbylleshin. Atëherë imzot Ernest Çoba u detyrua të kthehej pranë familjes. Prej derës atërore doli me pranga ndër duar. Ishte viti 1976. Gjyqi komunist e dënoi me 25 vjet burgim, si të ishte më i madhi kriminel. Akuzohej se kishte mbajtur lidhje me Selinë e Shenjtë me anën e legatës italiane.

Vuajti me durim të pasqorë, me shqetësimin e vetëm që t'i ngjante sa më shumë Krishtit në Kalvar, derisa vdiq në spitalin e burgut në Tiranë më 8 janar 1980. Ishte një vdekje misterioze, - siç dëshmon në librin e lartpërmendur imzot Simoni.

Mbyllte sytë pas një injeksioni që iu bë në ditët e para të janarit 1980, pak ditë para përkujtimit të Shën Ernestit. Për figurën e tij është shkruar disa herë, por meriton të bëhen përpjekje serioze për të mbledhur dëshmitë mbi qëndrimin heroik dhe fundin e jetës së këtij kryepeshkvi të jashtëzakonshëm, që jetoi e vdiq për Fe e Atdhe!

Radio Vatikani

Don Lush Gjergji
Prishtinë

I FRYMËZUAR NGA FEJA DHE DASHURIA

In memoriam

Don Zef Ramaj (1882-1914) – 100 vjetori i vdekjes

Don Zef Ramaj u lind në Stubëll më 8 gusht 1882 dhe vdiq në Shkup, më 25 dhjetor 1914. Ai kishte vijuar shkollën fillore në Prizren, të mesmen në Shkodër, teologjinë në Innsbruck, në Austri. Ky “*shtegtim*” për mësim, dije, edukim, sidomos dëshira e madhe dhe synimin jetësor për të arritur meshtarinë, dëshmon bindshëm karakterin e fortë dhe të vendosur të tij dhe të familjes, si pasardhës i denjë i “*Martirëve të Karadakut*” apo Anamoravës gjatë viteve 1846-1848. Kujtim ky që asokohe, si dhe sot, është gjithnjë i gjallë dhe i freskët në Stubëll dhe në rrethinë.

Ai e filloi shërbimin meshtarak në Selanik, për të vazhduar në Shkup, në fillim si ndihmës famullitar, pastaj si famullitar. Gjatë kësaj kohe, Don Zefi, kryente dhe detyrën e mësuesit dhe raportuesit për gjendjen kishtarë dhe kombëtare shqiptare. Këtë e kishte bërë sidomos në gazeta në gjuhën gjermane dhe shqipe, gjuhë këto që i njihte shumë mirë, në kohë tejet të vështirë dhe sfiduese për popullin Shqiptar dhe më gjerë.

Don Zefi e dinte fare mirë se kjo veprimtari do t'i shkaktonte shumë vështirësi, rreziqe. Mirëpo, ai tashmë ishte në shërbim të plotë ndaj Zotit, Kishës dhe Popullit, i udhëhequr nga e Vërteta dhe Dashuria, dëshira që t'i përngjaj Jezusit – Bariut të Mirë. Motoja tashmë e njohur e Imzot Pjetër Bogdanit “*Fati im është fati i Popullit tim*”, ishte shkruar dhe vulosur në shpirtin, mendjen, zemrën dhe ndërgjegjen e klerit katolik shqiptar, që jetonte dhe vepronte për binomi e pandashëm: “*Fe dhe Atdhe*”.

Deri me sot, për jetën dhe veprën e Don Zef Ramaj ndër ne është ditur shumë pak dhe në mënyrë të pjesshme, më tepër duke u mbështetur sipas gojëdhënës popullore dhe familjare, si ndonjë lloj legjende. Përse? Sipas mendimit time për shkaqe të shumta:

- **harresa**, që është lëshim dhe dobësi e jona gati karakteriale shqiptare, shpesh më e keqe dhe më e rrezikshme se vdekja;

- **për rrethana të pavolitshme dhe tejet të koklavitura**, sepse ishim të stërngarkuar me vetveten dhe mbijetesën tonë;

- **për mungesë të studiuesve të mirëfilltë të kësaj periudhe historike dhe mungesa gjurmimit të figurave tona**, sidomos nëpër arkivat të qendrave vendimmarrëse, ku gjendeshin njerëzit të shquar dhe të dalluar në lëmin kombëtar dhe fetar.

Njeriu i parë që pak më hollësisht është marrë me jetën dhe veprën e Don Zef Ramaj, është i ndjeri **Kristë Ramaj** me punimin e tij: *Jeta dhe vepra e Don Zef Ramaj*.

Nga ky shkrim dhe shënim nxjerrim të dhënat kryesore për të.

Sipas gojëdhënës Don Zef Ramaj, kujdesej për ushtarët që asokohe ishin të sëmurë prej lëngimeve të ndryshme në Shkup dhe rrethinë, duke ua ndarë ngushëllimin me sakramente, pra, duke ua mundësuar shtegtimin në amshim të pajisur me sakramentet e rrëfimit, kungimit dhe vajimit.

Mirëpo, ai nuk e kufizonte jetën dhe shërbimin e tij meshtarak vetëm në jetën shpirtërore dhe sakramentale, por edhe në nevoja të llojllojshme të njerëzve të asaj kohe dhe hapësire. Pati vëmendje të madhe edhe për “*Jetimore*” pranë famullisë, pra,



për fëmijë të mjerë, të braktisur, bonjakë, pa përkujdesje dhe dashuri, duke u bërë “ati”, mbrojtësi dhe përkrahësi i tyre në jetë.

Një aspekt tjetër që spikaste në jetën dhe shërbimin meshtarak të Don Zef Ramaj ishte kujdesi, përkrahja dhe puna e palodhshme për shkollën shqipe pranë famullisë së “Zemrës së Krishtit”. Ai e dinte fare mirë se dija dhe edukimi janë shtylla të nevojshme dhe të domosdoshme për njeriun, familjen dhe shoqërinë tonë, sidomos pas territ shumëshekullor dhe sundimit turko-otoman, i cili na kishte stërlodhur dhe rrezikuar në çdo segment të jetës dhe të veprimeve.

Sipas shkrimit të Kristë Ramaj, Don Zef Ramaj ishte helmuar natën e Kërshëndellave, më 25 dhjetor 1914, dhe kishte vdekur në moshën 32 vjeçare. Ishte varrosur në katedralen “Zemra e Krishtit” në Shkup. Pas tërmetit të vitit 1963 eshtrat e tij u barten nga Shkupi në Stubëll, ku edhe sot pushojnë.

Sipas informata që kemi, kuptohet se Don Zef Ramaj, kishte një edukim dhe formim të mirëfilltë të krishterë dhe evropian, ishte tërësisht në shërbim të Zotit, Kishës dhe Popullit, me jetë, shkrime, veprime, deri edhe me vdekje martire.

Dy fakte fatlume Don Zef Ramajn e bëjnë të shquar dhe të dalluar:

• **Pagëzimi i Gonxhe Anjeze Bojaxhiu, më vonë të së Lumes Nënës Terezë, më 27 gusht 1910 në katedralen “Zemra e Krishtit” në Shkup. Ja dëshmia e Nënës Terezë:** “Kam lindur në natën mes 26 dhe 27 gusht 1910. Para apo pas mesnatës, nuk e di, e as që ka rëndësi. Prindërit e mi fill në mëngjes më kanë sjellë në kishën “Zemra e Krishtit” në Shkup, ku më ka pagëzuar famullitari i atëhershëm Don Zef Ramaj. Prandaj është mirë që të shënohet datëlindja ime më 27 gusht, sepse atë ditë jam pagëzuar, kam lindur për Zotin...”.



• **Fjalimi përshëndetës dhe mirëardhës arqipeshkvit Imzot Lazër Mjeda në Shkup në vitin 1909**, që është ruajtur dhe botuar në “*Elçija e Zemrës së Krishtit*” në 1910, fq. 8-12, ku mund t'i gjejmë disa elemente baritore, kulturore dhe kombëtare, siç janë:

• Gëzimi dhe pritjet e klerit dhe të popullit të krishterë;

• Prania shqiptare katolike në Shkupin e atëhershëm, me 140 shtëpi;

• Famullia e parë që e vizitonte arqipeshkvi i ri Imzot Lazër Mjeda;

• Urimi dhe dëshira e Don zef Ramaj me këto fjalë: “Ah! Po me t'sakt, o i Shndritshmi Zotnii qi i Lumi Zot, kur e çove ti doren t'ande me e bekue popullin e Shkupit, edhe Ai i Lumi na ka bekue tui zgjedh Tye për Babë t'on, e lavd e nder i kjoft Zotit t'qiellës qe aq fort n'ket mendyrë na ka gzue, e Zot i qillës t'dhasht jetë t'gjat' e hire plot, për me kenë gjithmon yrneku i jonë, per me na sundue si asht vullnesa e Zotit e per me na çue te kroni i gjith t'mirave, te Zoti i qiellës e i dheut”. Meshtari D. Zef Ramaj, ndihmtaar i Famulliies t'Shkupit

Don Zef Ramaj, jetoj pak dhe shkurt, nuk i arriti as vitet e Jezu Krishtit, por diti përse dhe si të jetonte. Si meshtar katolik shqiptar, ishte i frymëzuar nga feja dhe dashuria, me anë të cilave arriti amshimin e lumtur, duke lenë gjurmë të pashlyeshme në historinë e kishës dhe kombit tonë.

■

Ndue DEDAJ

Rrëshen

**TË MËDHENJTË E SHEKULLIT XX
TË DON LUSH GJERGJIT**

(Mbi librin “Dashuria që nuk vdes”)

Në duar kemi librin më të fundit të Don Lushit, me një firmë të vetë autorit, me titullin domethënës “Dashuria që nuk vdes”, kushtuar njerëzve më të shquar të shekullit XX dhe teksa e shfletojmë faqe pas faqeje, me vete themi: “Edhe ai vetë është njëri nga ata”, por nuk e shqiptojmë me zë, se e dimë që modestia e tij nuk e pranon. Është një nga ditët e verës dhe drejt Stubllës, ku do të mbahet një festë e veçantë, kemi udhëtuar së bashku me Dom Nikë Ukgjinin, famullitar i Kuklit të Mjedës. Ajo anë e Karadakut është e gjitha në festë, pasi do të kremtohet 40-vjetori i shugurimit meshtarak të tre meshtarëve të mirënjohur kosovarë: Dom Lush Gjergjit e Dom Ndue Gjergjit (vëllezër) dhe Dom Aleksandër Kolës. Vetëm pak kohë më parë mes shqiptarëve të Amerikës bëhet një tjetër takim jubilar, dhe për faktin se atje prej 6 vitesh shërben Dom Ndue Gjergji, si ambasador i kishës shqiptare të Kosovës në SHBA. Kisha e Zojës Pajtores në Miçigan në shtator u vizitua nga Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani dhe iu dha titulli “Nderi i Kombit”, ka padyshim një meritë e ka dhe kreu i saj.

**Nga famullia e Binçës në Akademinë
Europiane**

Rrallë në kohët moderne ndodh të ketë oratorë të mëdhenj, sikur kjo zeje e lashtë të ketë mbetur në antikitet apo në Rilindje. Por jo, ka një njeri të paktën që duan ta dëgjojnë të gjithë e ky është Don Lushi. Ky personalitet i pazakontë poliedrik e poliglot mund të ishte profesor në Roma apo Paris, në Tiranë apo Prishtinë, mund të ishte në cilëndo akademi shkencash e kulture, mirëpo ai bën as më shumë e as më pak zakonin e misionarëve të mëdhenj, zgjedh për ta bërë veprën e vet një famulli të thjeshtë, atë të vendlindjes, ku qëndron aq gjatë, duke qenë njëherësh dhe mes popullit të tij dhe mes librave, arkivave, bibliotekave të huaja. Nuk shkoj Don Lushi ndër ato akademi për t'u ngulur atje, por i tërhoqi ato me vete, aty ku ai rronte e meshonte për 40 vite. Ky është një zakon i ndjekur nga paraardhësit e tij, po të kihet parasysh se Gjeçovi e bëri veprën e tij *Kanunin* në Gomsiqe të Mirditës, Mjeda *Anrrën e jetës* e shkroi në Kukël të Zadrimës, Bernardin Palaj *Visaret e Kombit* i solli prej



Dukagjini, Don Simon Filipaj *Biblën në shqip* e përktheu në një famulli të Ulqinit dhe Don Lush Gjergji *Nënë Terezën* e shkroi në Binçë të Karadakut, ku qëndroi rreth 15 vite. Janë këto vende të vogla, që prelatët e dijes iu dhanë emër të madh. Ashtu si vetë Gjon Buzuku do të na e sillte nga një famulli a dioqezë librin e parë të shqipes. Janë Krishlindjet e ti kujtohesh se ka qenë dramatike udha e shqiptarëve për te “Formula e Pagëzimit. Atë dimër të largët të vitit 1462 ipeshkvi Pal Engjëlli, teksa nxitonte kreshtave të Matit, për shkak të përndjekjes otomane, shkruante një lutje në shqip dhe ua linte në duar banorëve, që ata vetë t'i pagëzonin fëmijët e tyre: “Në emën të Atit, Birit e Shpirtit Shenjt”. Kanë kaluar shekuj e misioni ungjillizues e qytetërues i Dom Lushit e vëllezërve të tij të meshtarisë nuk ka të sosur.

**Orator i rrallë, publicist në zë, autor i 60
librave**

Po sjellim për lexuesin pak rreshta nga biografia e tij, shkëputur nga fjala e përshëndetjes në ceremoninë e 40-vjetorit të meshtarisë nga shqiptarët e Amerikës: “Don Lush Gjergji u lind në Stubëll të Epërme të Vitisë në vitin 1949. Shkollën fillore i kreu në vendlindje, gjimnazin klasik në

Dubrovnik, magistraturën për filozofi në Romë, ku dhe diplomoi në teologji e sociologji. Në vitin 1975 në universitetin shtetëror të Romës fitoi titullin doktor i shkencave në psikologji. Është shuguruar meshtar në Binçë më 11 gusht 1973. Qysh mbas shugurimit Dr. Don Lush Gjergji ka shërbyer pa ndërprerje në Kosovë, në Ferizaj, në Binçë, në Prizren dhe sot është vikar i pergjithshëm i Ipeshkvisë së Kosovës e shërben në katedralen e re “Nënë Tereza” në Prishtinë. Vite me radhë ka qenë redaktor dhe kryeredaktor i revistës fetaro-kulturore i shtëpisë botuese “Drita” me seli në Ferizaj. Është njohës i gjuhës së vjetër latine, i gjuhës së vjetër greke, i gjuhës italiane, gjermane, frenge, angleze dhe i gjuhëve sllave që fliten në Ballkan. Është anëtar i Akademisë Evropiane. Don Lush Gjergji është njëri nga intelektualët tanë më të njohur në të gjitha viset shqiptare dhe në diasporë. Ka kontribuar në disa fusha të jetës e të dijes. Përveç se është çmuar në misionin meshtarak, për të cilin edhe është shkolluar, veprimtaria e tij ka qenë e dalluar dhe në misionin humanitar e fisnik, pajtimin e gjakeve e atë të peshës së fjalës së gjallë, që e bëri të spikatur me aftësitë oratoriale e njerëzore, e cila i prek majat e ndërgjegjës së njerëzimit. Po ashtu Don Lush Gjergji është edhe një shkrimtar e publicist i njohur. Deri me tani ka botuar 60 libra, shumica prej të cilave janë përkthyer në më se 35 gjuhë të botës. Don Lush Gjergji është studiuesi më i plotë i veprës dhe jetës së Nënë Terezës, nga e cila ai u frymëzua qysh nga takimi i tyre i parë në vitin 1968. Jeta, vepra dhe mendimi i Don Lush Gjergjit është i lidhur ngushtë me figurën e Nënë Terezës, sa të flasësh për Nënë Terezën, nuk mund të rrish pa folur për Don Lushin dhe anasjelltas. Prandaj 13 nga librat e tij i kushtohen të Lumnuemes Nënë Tereza, të cilin Don Lushi e quan simbol i rilindjes dhe shpresës. Thelbi i veprës së tij është siç ai vetë thotë: “e vërteta në dashuri dhe për dashurinë”.

Të mëdhenjtë e shekullit, modele njerëzore për t'u ndjekur

Ata ishin projektur kohë pas kohe në ndërgjegjen e autorit si të mëdhenjtë e shekullit të njëzetë. Ndjen krenari për kombin tënd që në 26 figura madhore të shekullit të kaluar, tre janë shqiptarë: E Lumja Nënë Tereza, Patriku ekumenik i Kishës Ortodokse Atenagora I dhe Kardinal Mikel Koliqi, që gjejnë pasqyrim në këtë libër. Ajo që i bashkon personazhet e këtij libri është kumti i tyre i



dashurisë për njerëzimin, sakrifica dhe kushtimi ndaj paqes dhe triumfit të lirisë. Janë njerëz të mëdhenj ngë e gjithë bota, nga Italia, Franca, Anglia, Gjermania, Amerika, Polonia, Zvicra, India, Shqipëria etj. Njerëz të shquar të fesë dhe martirë të saj, burra dhe gra të papërsëritshme, kryesues të misionëve të mëdha humanitare dhe të paqes në vendet e varfëra, si Afrikë etj; papë, shenjtorë, shkrimtarë, politikanë tribunë, udhëheqës të kauzave të mëdha sociale, ndër ta jo pak nobelistë. Bien në sy figura të tilla si Rabindranath Tagore, Mohandas Gandhi, Martin Luther King, Gjoni XXIII, Pater Pio, Pali VI, Gjon Pali II, Edith Stein, Chiarra Lubich, Giorgio La Pira etj. Një antologji e tillë i thotë shumëçka lexuesit të sotëm, se sa më mundim janë krijuar disa nga vlerat e qytetërimit të sotëm, që kërcënohen nga luftërat, terrorizmi, armët kimike, genocidi, se në shekullin e shkuar kemi disa kollosë të heshtur nga të cilët na duhet ta kthejmë fytyrën sot e nesër, pasi ata nuk janë vetëm e shkuara. Po ashtu ky libër i thurur me mjeshtri nga autori, me elemente të biografisë së secilit protagonist, në stilin e esesë, me mjaft fotografi të spikatura nga vepra e tyre bamirëse, sjell para lexuesit modele të shpëtimtarëve të njerëzimit, në shëmbëllesë të Jezusit, përballë fuqive të errëta shkatërrimtare të shekullit XX si fashizmi, hitlerizmi, diktaturat e ndryshme etj. Misionarët e mëdhenj i përkasin si fillimit si fundit të shekullit të kaluar e me gjasë të tjerë vazhdojnë dhe në ditët e sotme, për të cilët do të shkruhet në të ardhmen. Veçse këta janë mes nesh si në kohët e para të misionëve, të “padukshëm”, që ne i shohim vetëm pasi të jenë bërë... Nënë Tereze! “Dashuria që nuk vdes” është vetë njeriu. Prandaj mbajeni sa më shumë në duar këtë libër të Dom Lush Gjergjit. Të rinjtë do të gjejnë aty një tjetër pamje të botës së shthurur jo pak nga vesi, kamja, droga, korrupsioni, nga shkëlqimi shpesh i rremë i modernes.

Dom Nikë Ukgjini
Shkodër

VËZHGIME PËR LETËRSINË BIBLIKE TË XANONIT (1863-1915)

Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore, “Mendje të ndritura të kulturës shqiptare , Anton Xanoni dhe Justin Rrota”, organizuar nga Universiteti i Shkodrës, me 19 dhjetor 2014.

Anton Xanoni, Ndre Mjeda, Dodë Koleci, Gjergj Fishta, Justin Rrota, si dhe shumë klerikë katolikë të tjerë, jetuan në kohën, kur kombi shqiptar do të fitonte pavarësinë e tij dhe gjuha shqipe po ridimensionohej si gjuhë e vjetër sa vetë kombi. Vlerësimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe ishte një ide që gjallëronte në mendjen dhe zemrën e këtyre autorëve.

Po t'i analizojmë hollësisht veprat e Xanonit, kuptojmë se çështja e njohjes dhe e përdorimit të gjuhës shqipe ka qenë shqetësim kryesor i gjithë veprimtarisë së tij albanologjike. Shqiptarët e kohës mjaftoheshin me ato pak njohuri për shqipen që e flisnin në mjedisin familjar apo në rrethin shoqëror. Në të kundërtën, Xanoni i mëshonte idesë se gjuha shqipe jo vetëm që duhet të ruhet, mësohet, por edhe të zhvillohet, pasurohet dhe pastrohet nga fjalët e huaja. Duke aluduar në unitetin e kombit, ai i mëshonte fort idesë së bashkimit të gjuhës në aspektin dialektor.

Synimi i këtij trajtimi nuk është vlerësimi

gjuhësor, letrar, poetik, hartimor, apo i përkthimeve të autorit, por, një vëzhgim i përkufizuar për letërsinë biblike të Xanonit.

Bibla vepër universale

Kultura e të gjithë njerëzimit e ka zanafillën e vet në besimet, qoftë për pjesën politeiste të historisë (besimi në shumë zota), qoftë për atë monoteiste (besimi në një Zot). Prandaj, nuk është diçka e rastit që fillimet e shkrimit të shumë gjuhëve, sidomos të popujve të Evropës si, gjuhët gjermanike, frankofone, sllave etj., e kanë zanafillën e tyre duke u mbështetur në letërsinë biblike.

Bibla, Shkrimi i shenjtë, nga greqishtja „He biblos“ që do të thotë „Libri“ ta biblia „libërthat“, ka në përbërje Besëlidhjen e vjetër, ku janë të renditura shkrime të një tradite gojore e shkrimore disa mijëra vjeçare, para Krishtit dhe Besëlidhja e Re, shkrime të kohës së apostujve, të shkruara deri vitin 100 pas Krishtit.

Në përmajtjen e tyre, Shkrimet biblike



përshkajnë të gjitha epokat historike, duke bërë një dialog të përjetshëm me to. Bibla, si libri më i botuar në botë, ka brenda vetes të gjitha gjinitë, që nga poema, poezia, letërsia, orakulli, rrëfimi historik, lutja, dialogu dhe ka më tepër se njëmijë personazhe.

Shumë shkrimtarë i janë kthyer autoritetit biblik, nga Marcel Proust-i (1871-1922), “Në kërkim të kohës së humbur” e deri tek Thomas Mann-i, (1875-1955), “Jozefi dhe vëllezërit e tij”. Francis Scot Fitzgerald-i (1896-1940), ndërton ëndrrën e Tokës së Premtuar të “Getsby i madh”, kurse Ernest Hemingway (1899-1961), merr nga imazhet biblike titullin e romanit të tij “Dhe dielli ngrihet përsëri” etj..

Edhe për rusët e shek. XIX, Bibla ka qenë një libër i pazëvendësueshëm. “Vëllezërit Karamazovë”, i Fjodor Dostojevskit (1821-1881), është frymëzuar nga pyetja e famshme e Jezusit drejtuar konsullit romak. Po ashtu, veprat e Nikola Vasiljevic Gogolit (1809-1852), Aleksandër Blokut (1880-1921), Boris Lenonidoviç Pasternakut (1890-1960), Anton Pavloviç Çehovit (1860-1904) etj..

Bibla është një burim i pashtershëm imazhesh, simbolesh, arketipash, formash rrëfyese ose poetike dhe e pandashme nga kultura në të cilën është formësuar.

Xanoni dhe letërsia biblike

Letërsia shqipe, si dhe shumë letërsi të kombeve evropiane, do niste me shkrimet e shenjta. Fillimet e shkrimit të shqipes, tani për tani i gjejmë te një formulë e pagëzimit, e cila mund të merret si një bekim hyjnor, për qëndrueshmërinë e letërsisë së vjetër shqipe. Kjo letërsi, edhe përkundrejt presionit dhe ndalimit nga Perandoria osmane, në saje të sakrificave titanike të bëra nga klerikët

katolik, do arrinte të mbijetonte, madje, gjatë rilindjes sonë kombëtare, ta zgjeronte shtratin e ngërthyer keqas për pesë shekuj me radhë nga perandoria e egër Osmane. Se këndejmi, ndikimi i diskursit biblik, do të ndikonte edhe në rrjedhat e konsolidimit të gjuhës shqipe, kulturës dhe në veçanti të letërsisë e poezisë sonë, gjatë periudhës së rilindjes sonë kombëtare. Kjo vetëm sa na përforcon argumentin se letërsia biblike, e nisur nga Buzuku, e vazhduar nga Budi, Bardhi, Bogdani, Variboba, Kristoforidhi, Mjeda, Xanoni, është shkollë letrare e njohur dhe e kalitur, brenda letërsisë shqipe.

Duke e ndier nevojën e një përparimi shpirtëror dhe letrar të popullit tonë, i cili gjendej në prag të pavarësisë, Xanoni, si klerik katolik, e kishte përqendruar veprimtarinë e vet, pos të tjerash, edhe të letërsia biblike e vjetër dhe e re shqiptare, duke u bërë një prodhues, hartues, e përkthyes i vyer dhe shumë i dobishëm për fushën e albanologjisë, e cila lëngonte prej shumë kohësh.

Veprat hartuese e përkthimore të përshpirtshme

Meqenëse jemi te një klerik dhe shkrimtar, i cili, sikur qëndron në ndarjen e epokave të zhvillimit historiko-letrar, veprimtarinë e tij me tematikë biblike, si, katekizmat, librat e uratave, fabulat me figura apo ngjarjet biblike, jetëshkrimet, poezitë kushtuar festave apo shenjtoreve të ndryshëm, nuk mund ta quajmë vetëm veprimtari religjioze apo liturgjike, si të ishim në kohën e realizmin socialist, por para së gjithash në planin letrar, duhet ta vlerësojmë si dukuri freskuese me vlera të larta letrare e artistike. Nga trajta e formuar e vargjeve të poezive e prozës të quajtura religjioze, pra fetare, te Xanoni, në fakt kuptojmë se fillon një ligjërim i mirëfilltë poetik e letrar i kultivuar fort mirë nga kultura jonë historike, nga Pal Hasi, Pjetër Budi,





Pjetër Bogdani, Jul Variboba, Pjeter Zarishi etj..

Sipas meje, janë edhe disa momente të tjera të karakterit artistiko-letrar, të cilat na ndihmojnë për ta formësuar dhe parafytyruar personalitetin e shkrimtarit Xanoni.

Veprat e quajtura religjioze apo të përshpirtshme dalë nga penda e tij, na zbulojnë edhe qëllimet humaniste dhe atdhetare, modestinë dhe altruizmin e tij etj.. Momente të tilla i gjejmë te disa nga veprat e autorit. Këtu do veçonim doracakun e përshpirtshëm “Shyhreti i divoçëm” (1912), ku janë të sistemuara 49 këngë-vargje të hartuara, apo qoftë edhe të përkthyer nga dora e Xanonit, si psh., kënga kushtuar Zojës së Shkodrës – “Nana e Këshillit të Mirë”; “Në Crna Gore kemi një Nanë”, kushtuar shenjtërores së njohur të Cernagorës afër Shkupit, në Kosovë; vargjet kushtuar Shën Rrokut, Shën Nikollës, apo këngët kushtuar Krishtlindjes etj..

Me nivelin e tij akademik e kulturor, Xanoni bënte pjesë tek intelektualët dhe shkrimtarët më të spikatur të kohës së tij. Këtë e dëshmon ndër të tjera edhe veprimtaria e tij si mësues, përkthyes dhe hartues i teksteve të klasicizmit letrar evropian. Dinamika dhe pasuria gjuhësore e Xanonit i kishte rrënjët tek njohuritë e tija të gjera e të shkëlqyera për gjuhët e huaja e në veçanti ato klasike, gjë që dëshmohet te veprat e letërsisë biblike, “Ekloga,” këngë baritore, “T’vertetat e Pasosme,” (1913),


marrë nga Alfons Liguori, përgatitur në gjuhën shqipe, ku me shumë mjeshtri gjuhësore, zbërthen të vërtetat teologjike, filozofike e dogmatike për jetën e përtejme. Gjithashtu dëshmi e zotërimit të gjuhëve klasike është përkthimi brilant i “Ungjillit sipas Mateut” (1915), ku pos tekstit bazë, ka referenca shpjeguese me përmbajtje teologjike, filozofike, historike, entografike etj.. Mjeshtëria përkthimore gjuhësore shihet edhe te veprat e tjera letrare biblike: te katekizmi, “Doktrina e Madhe”(pjesa 1-6), e papa Pio X; “Jeta e Shën Filip Nerit” (1899); “Jeta e Shën Stanislao Kostka” i Shoqërisë jezuite, 1908 etj..

Horizontin e gjerë intelektual, Xanoni e tregoi edhe duke hartuar me një lehtësi dhe qartësi të madhe gjuhësore, vepra letrare biblike, apo të përshpirtshme si, “Tremdhet t’martet e Shna Ndout”, hartuar në vitin 1901, (1920), doracaku prej 72 faqesh; “Jeta e Shna Ndou Abat”, Patriarka i vetmitarëve, 1908, me 36 faqe; “Jeta e Shën Françesk Saverit” (1916), me 256 faqe etj..

Duhet thënë se kanë mbetur shumë dorëshkrime të pabotuara nga fusha e letërsisë biblike. Ketë informacion e gjejmë te kopertina e librit “Ungjilli sipas Mateut”.

Fabulat sipas kodit të moralit biblik

Një prej qëllimeve të Xanonit si jezuit, ishte, që



mundësisht sa më shumë nga dija që kishte, t'ia përcillte rinisë, e cila i qe besuar atij si mësues dhe bari i shpirtit. Botimet e tij, në fillim kanë nganjëherë më tepër ton fetar, por pastaj sërish edhe ton nxitës-didaktik. Në këtë sfond pedagogjik janë vendosur edhe përkthimet e tij të fabulave, tregimeve dhe dramave me përmbajtje moralo-edukative, ku disa studiues të letërsisë e rendisin shumë lart autorin.

Disa prej veprave të tij e idealizojnë rolin e nënës në familje, të tjera atdheun e dashur nën pushtimin osman dhe sërish të tjera e potencojnë besimin në Kishën katolike. Nga këto vepra do të veçonim: “Muzhiktari i Verbtë”, kallxim i nanës, (1930), fabul; “Llogoret e Mullinjve”, dramë historike prej 5 aktesh (1902); “Gjenofeva”, roman, 1913; “Julia”, me personazhin Euzeb, roman, (Perparimi, 1915) etj..

Tomas Eliot do shprehej se e gjithë kultura perëndimore është mbështetur në antikitetin greko-latin dhe në Bibël. Prandaj, ky ndikim i Biblës në letërsinë shqipe është i natyrshëm edhe për arsye të rrethanave kulturore e civilizuese.

Sa i përket ndikimit të Biblës në letërsinë shqipe, sot, Sabri Hamiti shprehet se: letërsia jonë e shkruar që nga fillimi dhe për disa shekuj, është mbështetur në kodin biblik.

Për shkrimtarët e letërsisë së sotme, si, Anton Nikë Berisha, Anton Pashku, Engjëll Sejda,

Rrahman Deda, Kujtim Shala etj, personazhet, ngjarjet dhe kodi biblik janë bërë kulturë shkrimi dhe kulturë krijimi për kohën e sotme.

Nëpërmjet shumë autorëve, letërsia shqipe pretendon që ta ruajë vazhdimësinë e ndërlidhjeve funksionale me paramodelin e shkrimeve biblike, vazhdimësi e krijuar nga klasikët e vjetër. Letërsia biblike, shkrimi e komunikimi është bërë paradigmë letrare, referencë e këndimit dhe e rrëfimit artistik për t'u konsoliduar përfundimisht si shkollë letrare.

Përfundim

Ajo çfarë u tha më lart, është vetëm një prej aspekteve të mundshme të kundërimit dhe të vlerësimit të këtyre veprave madhështore të Xanonit. Autori i tyre ishte shkrimtar, poet, klerik i talentuar dhe i shkolluar në një mënyrë komplekse në lidhje me traditën e shkollës shqipe. Tekstet biblike shqiptare të Xanoni, paraqiten gjithashtu si një vlerë e veçantë dhe e përhershme, universale, shumë dimensionale, sa vetë Bibla. Prandaj një studim e një qasje reale ndaj këtyre teksteve, do t'i shërbente njohjes së vlerave të letërsisë kombëtare. Ky trupëzim i shkrimeve biblike krijon një letërsi ontologjike dhe e inkadron letërsinë shqipe në rrjedhat e letërsive të mëdha perëndimore, si edhe në traditën e shkrimit dhe të qytetërimit perëndimor.

SHËN VALENTINI MARTIR

(dita e të dashuruarve)

Nga goja e popullit ruhet kujtimi i gjallë për Shën Valentinin, posaçërisht nga një bazilikë e vjetër e Romës nga viti 350, që është pas emancipimit të fesë së krishterë me fetë e tjera të Perandorisë Romake (313).

Me 14 shkurt, Kisha Katolike përkujton Shën Valentinin, i cili ishte ipeshkëv në Terni afër Romës, në shekullin e tretë (270) dhe pësoi martirizimin gjatë përndjekjeve të Perandorit Klaudi.

Nga historia e Shën Valentinit dimë shumë pak. Dokumentet kishtarë pohojnë se ka qenë prift (presbiter) nga Roma, po ashtu një legjendë thotë se ishte edhe ipeshkvi i Ternit në afërsi të Romës.


Sipas biografisë që e sjell Kronika e Nurembergut (1493) dhe krahas me një portret klishe në dru të Shën Valentinit, teksti deklaron se ai ishte një prift nga Roma i martirizuar gjatë sundimit të Klaudit II, i njohur si Klaud Gothicus. Ai u arrestua dhe u burgos pasi u kap duke kurorëzuar (martuar) një çift të krishterë dhe një vepër e tillë konsiderohej si një krim. Atë kohë të krishterë persekutoheshin nga Klaud Cezari në Romë. Klaudi mori një simpati ndaj Valentinit të burgosur. Megjithatë, kur Valentin u përpoq që ta kthente perandorin në fenë e krishtere, u dënua me vdekje. Ai ishte rrahur me shkopinj dhe gurë. Kur nuk arritën ta vrisnin, iu pre koka jashtë Portës Flaminian (gjatë viteve 269, sipas disave, 270 ose 273).

Varri i tij ishte pranë urës Milvij. Nga goja e popullit ruhet kujtimi i gjallë për Shën Valentinin, posaçërisht nga një bazilikë e vjetër e Romës nga viti 350, që është pas emancipimit të fesë së krishterë me fetë e tjera të Perandorisë Romake (313). Sipas një veprë të fundshekullit V dhe fillimshekullit VI, të quajtur “Passio Marii et Marthae”, flitej për një legjendë në lidhje me bazilikën e Shën Valentinit në Romë (Basilica di San Valentino). Legjenda përsëritet, duke shtuar zbukurimet e portës shtesë në krye të varrit të tij, në Via Flaminia, ku Papa Juli I (357-352) kishte ndërtuar bazilikën e lashtë të Shën Valentinit. Kjo kishë u emërua me të vërtetë pas një tribuni nga shekulli i IV që dhuroi tokën dhe ku do të ndërtohej kisha e quajtur San Valentino

dhe ku do të ruheshin reliktet e martirëve deri në shekullin XIII, kur u transferuan në Santa Prassede.

Shumë shpejt do të popullarizohej pothuaj në tërë Evropën. Fjala Valentin buron nga fjala latine valens, që do të thotë i fortë, i denjë, i fuqishëm, i shëndoshtë dhe, si i tillë, ishte pajtori për mbrojtjen e të gjithave sëmundjeve trupore dhe ngjitëse. Po ashtu ai ishte edhe pajtori (patroni) i martesës fatlume, sepse festa e tij është në pragun e kreshmëve. Gjithashtu Shën Valentin ishte pajtori i bletëve dhe i rinisë, sepse me këtë datë dimri i ashpër përfundon, fillon pranvera dhe natyra zgjohet.

Festa e Shën Valentinit e ka një traditë të gjatë dhe të popullarizuar në botën e Perëndimit, posaçërisht të rinia. Në këtë ditë (14 Shkurt) si



djemtë, ashtu edhe vajzat dashurohen duke ia premtuar njëri-tjetrit besnikëri dhe dashuri. Shkëmbimi i kësaj besnikërie dhe dashurie është i llojllojshëm. Sot, pothuaj si djemtë, ashtu edhe vajzat ia shprehin njëri-tjetrit mirënjohjen e dashurisë dhe të besnikërisë me letërkëmbime, me kartolina në formë zemre që quhet "VALENTINI", po ashtu nuk mungojnë as format e tjera, siç janë dhuratat, që simbolizojnë dashurinë, unaza, vathë, varëse, lule, çokollata, këngët e dashurisë, poezitë etj..

Pse është Shën Valentini pajtori i të dashuruarve? Sipas një legjende të vjetër, Shën Valentini nga burgu i shkruan fshehtas vajzës së rojtarit letra dashurie me përshëndetje "nga Valentini i yt"! Një legjendë tjetër tregon se Valentini, në kohën e burgut, shëroi një vajzë të verbër të një familjeje pagane, duke ia kthyer pamjen e syve, dhe duke bërë që ajo të kthehej në fenë e krishterë. Sipas saj, Shën Valentini është edhe pajtori i syve dhe njohës i thellë i njeriut, që e simbolizon pamja e syrit. Një tjetër legjendë thotë, se Valentini ia riktheu shëndetin një fëmijë të paralizuar, që e kishte edhe epilepsinë. Mos të flasim edhe për një legjendë tjetër, në të cilën thuhet se Valentini qenka shoqëruar në burg me një fëmijë të vogël dhe bashkë me të organizonte postën, duke bartur letrat e dashurisë dhe duke ia shpërndarë të burgosurve.

Një shpjegim tjetër thotë se festa e Shën Valentinit e ka zanafillën nga festivali pagan i quajtur "Lupercalia", që buron nga fjala latine "lupus" (ujk). Me këtë festival romakët kremtonin festën e Familjes (Lupercus), që ishte e njëjtë me festën greke "Pan". Domethënia e festivalit dhe e festës ishte për t'u mbrojtur nga ujqit. Po ashtu ky festival përputhet edhe me festën e patronatit të "Junonës", që, sipas mitologjisë së vjetër romake ishte motra dhe grua e Jupiterit dhe hyjnesha e dashurisë. Edhe gjatë këtij kremtimi madhështor, si djemtë e rinj, po ashtu edhe vajzat e reja, zgjidhnin partnerët e tyre. Zakonisht, djali i propozon për martesë vajzës, të cilën e dashuron. Me ardhjen e krishterimit kjo traditë do të vazhdojë jo më me hyjneshën e dashurisë, por me Shën Valentinin, i cili bëhet tani patroni i dashurisë për të rinjtë.

Përpos kësaj kemi edhe shpjegime tjera për Shën Valentinin. Në besimin e vjetër anglez, pikërisht në këtë ditë (14 shkurt), zogjtë zgjedhin çiftin e vet, mashkulli femrën dhe femra mashkullin. Chaucer-i në shënimet e veta nga shekulli XIV, përmend edhe shkëmbimet e të dashuruarve. Po ashtu është e mundshme që

rastësisht përputhet festa e Shën Valentinit me kohën e pranverës, kur gjithçka fillon të zgjohet dhe, tek rinia fillon të zgjohet dashuria. Kjo festë është për rininë amerikane dita më e popullarizuar, në të cilën bëhen shkëmbimet dhe dhuratat në emër të dashurisë dhe për dashuri mes djemve dhe vajzave.

Shën Valentinit mbetet edhe më tutje në listën zyrtare të Kishës Katolike të shenjtorëve (Martirologu romak), por, duke pasur parasysh mungesën e informacionit në lidhje me të, përkujtim i tij u hoq nga Kalendar i liturgjik i përgjithshëm dhe u zëvendësua me Shën Cirilin dhe Metodin, pajtorët e Evropës (1969), por shumë shtete e lusin me kalendarin e vjetër, me 5 korrik. Festa e Shën Valentinit është përfshirë në kalendarët lokale të vendeve ku Shën Valentinin është i popullarizuar, si Balzan në Maltë. Në Mesharin romak ka mbetur si përkujtim jo i detyrueshëm, autorizuar në përputhje me 2007 "Motuproprio" të Papa Benediktit XVI, në "Summorum Pontificum".

14 shkurti festohet si Dita e Shën Valentinit edhe në kishat e tjera të krishtera. Në Kishën e Anglisë, për shembull, ajo u përfshi në Kalendar para Reformimit, dhe Shën Valentini, Ipeshkëv dhe Martir, u rivendos në kalendarin e Kishës në Librin e liturgjik (1661/1662). Ai mbetet në Kalendarët e Kishës së Anglisë dhe në bashkësitë e tjera fetare.



“MENDJE TË NDRITURA TË KULTURËS SHQIPTARE”

Atë Anton Xanoni SJ. dhe Atë Justin Rrota, OFM.

Konferencë Shkencore

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike, me dt. 19 dhjetor 2014, organizuan Konferencën shkencore: “Mendje të ndritura të kulturës shqiptare” kushtuar, dy personaliteteve të shquara të kombit, Atë Anton Xanoni, SJ. (1863-1917) dhe Atë Justin Rrota, (1889-1964) OFM.

Studiuesit nga Tirana dhe Universiteti i Shkodrës, në Konferencën një ditore, të ndarë në dy seksione, dhanë vlerësimet tyre për Xanoni dhe Rroten, duke mbajtur 29 ligjërata nga fusha, e gjuhësisë, letërsisë, përkthimeve dhe teologjisë biblike. Nga temat shumta do

përmendim, të Prof. Tomor Osmanit: “Justin Rrota gjuhëtar i shquar i shekullit të kaluar”; Prof. Fatbardha Hoxha, “Justin Rrota, ndër të paret, studiues të letërsisë shqipe”; Akademik Kolec Topalli, “Kontributi i Justin Rrotes për etimologjinë e shqipes” etj.. Nga kumtesat për Anton Xanonin i cili për shumë pjesëmarrës doli shumë me pak i njohur në krahasim me Rroten, do përmendim ligjëratorin e Mimoza Priku, Tef Topalli, “Çaste nga jeta, në formimin arsimor e kulturore, si dhe kontributi pedagogjik i Anton Maria Xanonit”; Dom Nikë Ukgjini, “Vëzhgime për letërsinë biblike të Xanonit”, ku ndër të tjera theksoi, “Po t’i analizojmë hollësisht veprat e Xanonit, kuptojmë se çështja e njohjes dhe e



përdorimit të gjuhës shqipe ka qenë shqetësim kryesor i gjithë veprimtarisë së tij albanologjike. Shqiptarët e kohës mjaftoheshin me ato pak njohuri për shqipen që e flisnin në mjedisin familjar apo në rrethin shoqëror. Në të kundërtën, Xanoni i mëshonte idesë se gjuha shqipe jo vetëm që duhet të ruhet, mësohet, por edhe të zhvillohet, pasurohet dhe pastrohet nga fjalët e huaja. Duke synuar bashkimin e kombit, ai i mëshonte fort idesë së bashkimit të gjuhës në aspektin dialektor....”

“Duke e ndier nevojën e një përparimi shpirtëror dhe letrar të popullit tonë, i cili gjendej në prag të pavarësisë, Xanoni, si klerik katolik, e kishte përqendruar veprimtarinë e vet, përveç të tjerash, edhe tek letërsia biblike e vjetër dhe e re shqiptare, duke u bërë një prodhues, hartues, e përkthyes i vyer dhe shumë i dobishëm për fushën e albanologjisë, e cila lëngonte prej shumë kohësh”.



Gjokë Dabaj

**E KALUARA E VERTETË
E ARQIPESHKVISË SË
TIVARIT**

*Botimet ART CLUB,
Ulqin, 2014*



Ben Blushi

HËNA E SHQIPËRISË

Botimet UET , Tiranë 2014



**VATIKANI DHE
SHQIPTARËT**

Përgatitur nga Lazër Stani

Gjergj Fishta, Lezhë 2014

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 1/2 (472-473) Janar - Shkurt 2015